

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6767
E premte, 25 nëntor 2022
çmimi 0.40

Mavraj për marrëveshjen për targat: E tëra është propagandë | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KOSOVA DHE SERBIA KANË ARRITUR MARRËVESHJE PËR TARGAT | FAQE 4-5

OPOZITA KRITIKON KURTIN PËR QASJEN NË DIALOG, KËRKON TRANSPARENCË



Kryeministri Albin Kurti ka thënë të enjten para deputetëve të Kuvendit se në Bruksel nuk ka pasur marrëveshje, por pajtim për targat. Ai ka theksuar se tash palët do të përqendrohen në normalizimin e plotë të marrëdhënieve mes dy shteteve, duke u bazuar në planin franko-gjerman për

marrëveshjen përfundimtare. Partitë opozitare e kanë mirëpritur marrëveshjen, e cila, sipas tyre, ka shmangur përshkallëzimin dhe eskalimin potencial të situatës në veri, duke kërkuar nga Kurti transparencë në dialog para Kuvendit të Kosovës


USHTRIA ÇLIRIMTARE E KOSOVËS DHE KONFERENCA E RAMBUJESË



Prof. dr. Paskal MILO



FAQE 6-9



VULLNETARËT E RINJ TË KORPUSIT TË PAQES FILLOJNË SHËRBIMIN DYVJEÇAR NË KOSOVË

FAQE 10

AKTUALE



KINA SHTON MASAT KUFIZUESE PAS RRIJES REKORDE TË RASTEVE ME COVID-19 | F. 2

KATËR AUTOAMBULANCA TË REJA I SHTOHEN QKMF-së NË PRISHTINË | F. 3

NJERIU I SHËRBIMIT SEKRET SERB BASHKËPUNOI ME ZPS-NË, DËRGOI DËSHMITAR TË RREJSHËM KUNDËR THAÇIT DHE VESELIT | F. 3


EKONOMI



BE-ja ANULON GRANTIN 28 MILIONË EURO TË FONDIT TË INVESTIMEVE PËR PORTIN E DURRËSIT | F. 10

ODA EKONOMIKE E KOSOVËS DHE AJO E KROACISË DISKUTOJNË PËR BASHKËPUNIM | F. 10

SPORT



BRAZILI TREGON FORCËN NDAJ SERBISË, PORTUGALIA MPOSHTI GANËN | F. 12

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANKIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Kina shton masat kufizuese pas rritjes rekorde të rasteve me Covid-19



PEKIN, 24 NËNTOR - Kufizime shkakoi i pandemisë Covid-19 po vendosen në të gjithë Kinën, përfshirë një qytet ku punëtorët e një fabrike u përleshën këtë javë me policinë, pasi numri i rasteve të Covid-19 po thyen rekorde ditore.

Banorëve të tetë rajoneve në Zhengzhou, ku banojnë 6.6 milionë njerëz, iu tha të qëndrojnë në shtëpi për pesë ditë duke filluar nga e enjta, përveç për blerje të ushqimit ose trajtime mjekësore. Testim masiv ditor u urdhërua si pjesë e asaj që qeveria e qytetit e quajti "luftë asgjësimi" kundër virusit.

Gjatë përplasjeve të së martës dhe mërkurës, policia e Zhengzhou i rrahu punëtorët që po protestonin për një mosmarrëveshje lidhur me pagat në fabrikën më të madhe të telefonit të mençur Iphone, nga kompania Apple, që ndodhet në zonën industriale afër qytetit.

Foxconn, pronarët nga Tajvani, kërkuan falje të enjten për "një gabim teknik në sistemin kompjuterik" dhe thanë se do të garantonin se pagesat do të bëheshin ashtu siç ishin marrë vesh fillimisht dhe siç ishte paralajmëruar gjatë rekrutimit.

Gjatë 24 orëve paraprake ishin regjistruar 31.444 raste të reja me Covid-19, tha Komisioni Kombëtar i Shëndetësisë të enjten. Kjo është shifra më e lartë e regjistruar në qytetin Wuhan që kur ishte detektuar për herë të parë virusi në fund të vitit 2019. Numri ditor i rasteve të reja ka qenë në rritje kohët e fundit. Këtë javë, autoritetet raportuan për vdekjen e parë shkakut i Covid-19 në gjashtë muajt e fundit, duke e çuar totalin në 5.232.

Përderisa numri i rasteve dhe vdekjeve është relativisht i ulët në krahasim me ato në ShBA dhe në vendet të tjera, Partia Komuniste

e Kinës mbetet e përkushtuar ndaj strategjisë "zero-Covid" që synon ta izolojë çdo rast dhe ta eliminojë virusin plotësisht. Shumica e qeverive të tjera i kanë dhënë fund kufizimeve dhe llogarisin vetëm në vaksinim dhe imunitet të qytetarëve shkakut i infektimit të kaluar në parandalimin e vdekjeve dhe sëmundjeve serioze.

Bizneset dhe komunitetet rezidenciale, nga qendra prodhuese e Guangzhou deri në Pekin, kanë masa kufizuese të ndryshme, të cilat prekin veçanërisht punëtorët emigrantë. Në shumë raste,

banorët thonë se kufizimet shkojnë përtej asaj që lejon qeveria kombëtare.

Përderisa kufijtë e Kinës mbeten kryesisht të mbyllur, qeveria ka "optimizuar dhe lehtësuar procesin e daljes dhe hyrjes për ekzekutivët, personelin e specializuar të kompanive shumëkombëshe, bizneseve të huaja dhe anëtarëve të familjeve të tyre në Kinë", tha zëdhënësi i ministrisë së Jashtme Mao Ning në një konferencë të përditshme për media të enjten.

Mao tha se Kina do të vazhdojë t'i përmirësojë protokollet e Covid-19 "sipas parimeve të bazuara në shkencë" për të ndihmuar në lehtësimin e udhëtimit dhe bashkëpunimit me vendet e tjera. Një problem kryesor është shqetësimi se sa të ndjeshëm janë njerëzit ndaj virusit. Një numër jo shumë i madh i kinezëve janë infektuar me Covid-19 ose janë ekspozuar ndaj virusit, kështu që vetëm një përqindje e vogël mendohet se kanë krijuar nivele efektive të antitropave që luftojnë virusin.

Kina ka një shkallë të përgjithshme vaksinimi kundër koronavirusit prej më shumë se 92 për qind dhe shumica e njerëzve kanë marrë të paktën një dozë. Por një numër më i vogël i të moshuarve - veçanërisht ata mbi moshën 80 vjeç janë vaksinuar.

Qeveria po përpiqet të frenojë valën e fundit të infektimit pa i mbyllur fabrikat dhe pjesën tjetër të ekonomisë së saj, siç bëri në fillim të vitit 2020. Një taktikë është përdorimi i "qarkut të mbyllur", sipas të cilit punëtorët do të jetonin në fabrikat ku punojnë, pa pasur kontakt me botën jashtë.

Zelensky i bën thirrje Këshillit të Sigurimit t'i ndalojë sulmet ruse

KIEV, 24 NËNTOR - Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky i ka bërë thirrje Këshillit të Sigurimit të OKB-së që të ndërmarë veprime për t'i ndaluar sulmet ajrore ruse që synojnë infrastrukturën në vendin e tij. Kjo thirrje erdhi pasi një tjetër sulm masiv raketor rus, më 23 nëntor, vrau gjashtë persona dhe ndërpreu energjinë në disa qytete ukrainase. "Sot është vetëm një ditë, por ne jemi goditur nga 70 raketa. Kjo është formula ruse e terrorit", ka theksuar Zelensky në mbledhjen e këshillit përmes një videolidhjeje.

Ai ka pohuar se raketat kanë goditur spitalet, shkollat, infrastrukturën e transportit dhe

zonat e banuara, duke shtuar se Ukraina po pret të shohë "një reagim shumë të fortë" nga bota. "Ne nuk mund të jemi peng i një terroristi ndërkombëtar", ka thënë ai.

Zelensky i bëri thirrje që Ruisë të mos i jepet e drejta e votës për çfarëdo vendimi që ka lidhjet me veprimet e Ruisë.

Ambasadorja e ShBA-së në OKB, Linda Thomas-Greenfield, ka theksuar se presidenti i Ruisë, Vladimir Putin, po e "përdor qartësisht dimrin si armë për t'i shkakuar vuajtje të mëdha popullit ukrainas".

Presidenti rus "do të përpiqet ta ngrijë vendin për t'iu nënshtruar", ka shtuar ajo.



Skandal në Speciale: Njeriu i shërbimit sekret serb bashkëpunoi me ZPS-në, dërgoi dëshmitar të rrejshëm kundër Thaçit dhe Veselit

PRISHTINË, 24 NËNTOR - Një dëshmitar ka dhënë deklaratat të rrejshme në Gjykatën Speciale kundër Hashim Thaçit dhe Kadri Veselit, duke pretenduar se ata ishin përgjegjës për rrjedhjen e dokumenteve për të cilat janë gjykuar dhe dënuar krerët e veteranëve të luftës Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj.

Më pas, ky person, identiteti i të cilit nuk është zbuluar, ka tërhequr deklaratat e tij, duke pohuar se ishte nxitur nga një person tjetër që të gënjente.

Dëshmitari që kishte dhënë deklaratat të rrejshme, si dhe personi që e kishte nxitur për t'i dhënë ato deklaratat, del se kishin lidhje me shërbimin sekret serb.

Ky është zbulimi shokues që ka bërë ekipi mbrojtës i Kadri Veselit të paraqesë një parashtrësë, e cila është publikuar në faqen zyrtare të Dhomave të Specializuara të Kosovës (Gjykatën Speciale).

Personi që kishte nxitur këtë dëshmitar të trillonte, të cilin mbrojtja e quan "informator", sipas shkresës, kishte pasur kontakte të rregullta dhe të drejtpërdrejta me Zyrën e Prokurorit të Specializuar (ZPS) dhe me prokurorin e specializuar.

"Në tetor 2022 një dëshmitar u paraqit për të pretenduar se z. Veseli dhe z. Thaçi ishin përgjegjës për rrjedhjen e dokumenteve që ishin në qendër të rastit Gucati dhe Haradinaj pranë Dhomave të Specializuara të Kosovës. (Redaktuar) Këtë vit dëshmitari tërhoqi pretendimet e tij dhe pohoi se jo vetëm që kishte gënjyer, por që edhe ishte nxitur të gënjente nga një informator – i cili (i) kishte qenë në kontakt të rregullt me Zyrën e Prokurorit të Specializuar; (ii) duket se ishte pika e tyre e kontaktit për një numër dëshmitarësh në gjykim, dhe (iii) pohon se ka pasur kontakte të rregullta dhe direkte me Prokurorin e Specializuar", është thënë në shkresën e nënshkruar

nga avokatit i Veselit, Ben Emmerson.

Në seancën e 15-të statusore, të mbajtur më 4 nëntor 2022, mbrojtja ka thënë se ka adresuar zbulimin e transkriptimit të intervistës së (pjesë e redaktuar në shkresë) që shpërfaq se ai rrejshëm ka implikuar Thaçin dhe Veselin në rastin Gucati, sipas instruksioneve të (pjesë e redaktuar), dhe që të dy këta persona kanë lidhje me shërbimin sekret serb, ndërsa që (pjesë e redaktuar), po ashtu del se ka vepruar si ndërmjetësues i Zyrës së Prokurorit të Specializuar.

"Më (redaktuar), (redaktuar) tërhoqi deklaratën e tij të mëparshme, duke rrëfyer se ai ishte ushqyer me informata nga një person i quajtur (redaktuar) i cili bashkëpunon ngushtë si me inteligjencën serbe, po ashtu edhe me Zyrën e Prokurorit të Specializuar", është thënë në shkresën e avokatit Ben Emmerson.

Po ashtu, mbrojtja ka zbuluar se si ky person, në një moment gjatë intervistës, kishte përshkruar takimin e tij me zyrtarë të ndryshëm serbë në Beograd.

"Transkriptimi e bën të qartë se (redaktuar) ka një marrëdhënie me Shërbimin Sekret Serb. Në një moment të intervistës ai e informoi Zyrën e Prokurorit të Specializuar rreth planeve të tij për të udhëtuar në Beograd (redaktuar), ku do ta takonte burimin e tij (redaktuar), në mënyrë që të ishte në gjendje të siguronte më shumë përgjigje për Zyrën e Prokurorit të Specializuar. Më (redaktuar), (redaktuar) ka dhënë intervistën e dytë për Zyrën e Prokurorit të Specializuar (redaktuar), për të rrëfyer se atij i ishte thënë se çfarë të thoshte (redaktuar) në deklaratën e tij nga një njeri (redaktuar), i cili i ishte prezantuar dëshmitarit si (redaktuar). Intervistuesi kryesor në këtë rast ishte prokurori i lartë



(redaktuar). (Redaktuar) ka pohuar se (redaktuar) (redaktuar) te Zyra e Prokurorit të Specializuar dhe që (redaktuar) - me të cilin (redaktuar) ka një lidhje të fortë - ishte i vetëdijshëm për fabrikimin. Ai sqaroi që Zyra e Prokurorit të Specializuar kishte nevojë për më shumë fakte që t'i mbante të burgosur të akuzuarit", është thënë në shpresën e avokatit të Veselit.

Më tutje, ky dëshmitar kishte gënjyer se Thaçi dhe Veseli kishin paguar zyrtarët serbë për t'i marrë dokumentet e Zyrës së Prokurorit të Specializuar që kishin rrjedhur në publik.

Duke iu referuar intervistës së dëshmitarit të rrejshëm, mbrojtja ka thënë se ai kishte deklaruar të ketë pasur edhe një kontratë të shkruar, e cila do ta vërtetonte tregimin e tij, dhe se posedonte screenshots të mesazheve dhe thirrjeve ndërmjet tij dhe dikujt - emri i të cilit është i redaktuar në shkresë.

Mbrojtja e Veselit, për më tepër, ka përmendur një rrjet të

dëshmitarëve të dërguar në Gjykatën Speciale nga një individ.

"(Redaktuar) del të jetë qendra e një rrjeti të dëshmitarëve të cilët ai i kishte ofruar direkt ose indirekt në Zyrën e Prokurorit të Specializuar. Mbrojtja ka të dhëna për 15 kontakte që (redaktuar) ka pasur me Zyrën e Prokurorit të Specializuar, të cilat datojnë prej (redaktuar) 2017. Sipas vlerësimit të mbrojtjes, (redaktuar) ka ngritur pretendime dhe ka dhënë komente për më shumë se 60 individë gjatë bisedave të tij me Zyrën e Prokurorit të Specializuar. Në mënyrë rutinore, ai ka ofruar ose pretenduar ta vë Zyrën e Prokurorit të Specializuar në kontakt me persona relevantë për hetimet", është thënë në shkresën e mbrojtjes së Veselit.

Mbrojtja e Veselit ka alarmuar se ky skandal i zbuluar, ku një ndërmjetësues i Zyrës së Prokurorit të Specializuar, i lidhur me shërbimin sekret serb, ka udhëzuar një dëshmitar që të gënjejë, në deklaratat e të cilit Prokuroria e Specializuar është

mbështetur dhe i ka përsëritur publikisht në dëm të të akuzuarve, është katastrofike për integritetin e rastit të Prokurorisë kundër krerëve të UÇK-së.

"Akuzat e bëra nga (redaktuar) kundër (redaktuar) në deklaratën e tij të dytë janë jashtëzakonisht serioze. Në zemër të rastit të Prokurorisë në dukje është një ndërmjetësues i besueshëm, i cili ka udhëzuar një dëshmitar të dalë me gënjeshtër, në të cilat Prokuroria është mbështetur dhe i ka përsëritur publikisht në dëm të të akuzuarve. Akuza të tilla janë potencialisht katastrofike për integritetin e rastit të Prokurorisë, duke marrë parasysh shtrirjen e kontakteve të Zyrës së Prokurorit të Specializuar me (redaktuar). Çdo prokuror etik do të kishte kuptuar menjëherë pas marrjes së atij kontakti të dytë me (redaktuar) cilat mund të ishin implikimet për rastin e tij dhe do të kishte ndërmarrë menjëherë hapa për të hetuar shkallën e kontaminimit", është thënë në shkresën e avokatit të Kadri Veselit.

Mavraj për marrëveshjen për targat: E tëra është propagandë

PRISHTINË, 24 NËNTOR (ER) - Publicisti Muhamet Mavraj ka reaguar pas arritjes së marrëveshjes në mes të Kosovës dhe Serbisë për çështjen e targave të mërkurën mbrëma në Bruksel. Mavraj në "Facebook" ka shkruar se kjo marrëveshje është propagandë. Ai ka thënë se Kosova do ta humbë edhe njohjen e tabelave dhe letërnjoftimeve. "E tëra është propagandë. Pas humbjes së përkrahjes së miqve perëndimorë, nuk do të ketë njohje të Kosovës nga Serbia as në qendër, as në periferi, madje as në margjina të çfarëdo plani a diskutimi, as njohje të ndërsjellë, as kurrëfare. Do ta humbim edhe njohjen e tabelave dhe letërnjoftimeve tashmë të humbura", ka shkruar Mavraj.



Postimi i plotë i Mavrajt:

Perifrazim i asaj çfarë kam thënë në tri televizione dhe në 'Radio Kosova' gjatë tetorit e nëntorit:

E tëra është propagandë. Pas humbjes së përkrahjes së miqve perëndimorë, nuk do të ketë njohje të Kosovës nga Serbia as në qendër, as në periferi, madje as në margjina të çfarëdo plani a diskutimi, as njohje të ndërsjellë, as kurrëfare. Do ta humbim edhe njohjen e tabelave dhe letërnjoftimeve, tashmë të humbura. Ky ishte thelbi.

Hajt zeko hajt! Grahi rrushe grahi!

Jo dorëheqje! Jo shkarkime! Pa ungi mirë, jo! Pastaj dihet...

PS: Për ata që kanë ndërgjegje: Votuesit e tyre le të merren me ta. Ne kemi njohur vullnetin e lirë të secilit votues.





KOSOVA DHE SERBIA KANË ARRITUR MARRËVESHJE PËR TARGAT

Opozita kritikon Kurtin për qasjen në dialog, kërkon transparencë

Kryeministri Albin Kurti ka thënë të enjten para deputetëve të Kuvendit se në Bruksel nuk ka pasur marrëveshje, por pajtim për targa. Ai ka theksuar se tash palët do të përqendrohen në normalizimin e plotë të marrëdhënieve mes dy shteteve, duke u bazuar në planin franko-gjerman për marrëveshjen përfundimtare. Partitë opozitare e kanë mirëpritur marrëveshjen, e cila, sipas tyre, ka shmangur përshkallëzimin dhe eskalimin potencial të situatës në veri, duke kërkuar nga Kurti transparencë në dialog para Kuvendit të Kosovës

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHINË, 24 NËNTOR - Partitë opozitare në Kosovë e kanë mirëpritur arritjen e marrëveshjes me Serbinë për targa ilegale serbe. Përveç kësaj, në seancën parlamentare të Kuvendit të Kosovës deputetët opozitarë kërkuar nga kryeministri Albin Kurti më shumë sqarime rreth marrëveshjes së arritur si dhe dialogut rreth marrëveshjes finale. Kosova dhe Serbia më 23 nëntor në Bruksel kanë arritur marrëveshje për targa ilegale serbe.

Kosova është pajtuar të mos vazhdojë tutje zbatimin e vendimit për reregjistrimin e automjeteve me targa ilegale serbe në RKS, kurse Serbia që të mos lëshojë targa të reja serbe sikurse ato KM (Kosovska Mitrovica -

Mitrovica e Kosovës). Megjithatë, hollësi interesante janë parë në marrëveshjen e plotë të publikuar tashmë në medie.

Nga komunikata zyrtare e Brukselit bëhet me dije se palët do t'i respektojnë në tërësi marrëveshjet e mëparshme. Paragrafi i dytë i pikës së tretë thotë qartë që të gjitha marrëveshjet e mëparshme do të respektohen. "Palët pranojnë që të gjitha marrëveshjet e mëparshme do të respektohen", shkruan ndër të tjera.

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, tha se e mirëpret pajtimin që ka ndodhur të mërkurën në Bruksel që, sipas tij, shmang përshkallëzimin potencial të situatës në veriu e vendit.

Krasniqi ia ka propozuar pesë pika kryeministrit Kurti për marrëveshjen finale me Serbinë,

për të cilat, ka thënë ai, se do ta ketë mbështetjen e plotë të PDK-së. "Dëshiroj të ritheksoj këtu qëllimet kryesore që mund dhe duhet të arrihen në fund të procesit, që janë qëllime jo vetëm të PDK-së, por të të gjithë spektrit politik të Kosovës dhe qytetarëve të vendit tonë. Duke të inkurajuar për vendosmëri dhe fokus në arritjen e marrëveshjes finale, ju ftoj që këto pesë shtylla t'i keni bazë të dialogut. 1. Ruajtja e karakterit unitar të shtetit tonë sipas rregullimit aktual kushtetutës; 2. Njohja formale nga pesë shtetet mosnjohëse të BE-së; 3. Nisja e procesit të anëtarësimit në NATO përmes pjesëmarrjes në partneritetin për paqe si hap i parë; 4. Marrja e statusit të shtetit kandidat për anëtarësim në BE; 5. Njohja e ndërsjellë në mes të Kosovës dhe Serbisë", ka propozuar Krasniqi.

Armend Zemaj, deputet i Lidhjes Demokratike të Kosovës, ka pohuar se ngjarjet e fundit lidhur me targa që ndodhën kanë qenë të panevojshme dhe të dëmshme për shtetin e Kosovës. "Kthimi dhe pranimi i marrëveshjes së njëjtë tregon qasjen joserioze dhe paafësinë tuaj [Albin Kurti] përballë përgjegjësive shtetërore që keni për vendin dhe Kosovën. Domsdo, duhet transparencë në dialog para Kuvendit, qytetarëve të Kosovës dhe jo deklarata kontradiktore, jo qasje selektive, jo injorim ndaj nesh, qytetarëve dhe ndaj partnerëve strategjikë, mbi të gjitha Shteteve të Bashkuara", ka thënë ai.

Edhe kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, ka theksuar se e mirëpret marrëveshjen, e cila, sipas tij, evitoi rrezikun për përshkallëzim të situatës në veri. Megjithatë, sipas tij, me marrëveshjen nuk është zgjidhur situata në veri. "Sfida që e pret Kosovën është rikthimi i atyre që i kanë lëshuar vendet e punës apo plotësimi i pozitave", ka thënë Haradinaj. Arritjen e marrëveshjes e ka mirëpritur edhe ShBA-ja.

Ambasadori amerikan në Kosovë, Jeffrey Hovenier, ka thënë se marrëveshja e arritur të mërkurën në mes të Kosovës dhe Serbisë për targa e shton sigurinë dhe avancojnë përpjekjet për normalizim mes vendeve. "Vlerësojmë qasjen konstruktive dhe fleksibilitetin që rezultoi në këtë marrëveshje të rëndësishme ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Marrëveshja shton sigurinë dhe avancojnë përpjekjet për normalizimin e marrëdhënieve", ka shkruar ai në "Twitter". Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, e ka falënderuar Ambasadën Amerikane në Kosovë për angazhimin e saj për arritjen e marrëveshjes për targa ilegale serbe. "Mbështetja e saj për procesin e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë është kyçe. Kosova është mirënjohëse", ka shkruar ajo në "Twitter".

Kthimi i serbëve në institucione është çështje ligjore

Kreu i PDK-së, Memli Krasniqi, i ka thënë Kurtit se nga marrëveshja e arritur për targa ka një paqartësi,

nëse pritet kthimi i serbëve në institucionet e Kosovës. Kryeministri ka thënë se kthimi i tyre në institucione nuk mund të bëhet politikisht dhe se kjo është çështje juridiko-ligjore e kushtetuese. “Unë u kam bërë thirrje të gjithë serbëve që janë në institucione, mos i braktisni ato, mos jepni dorëheqje. Por, nuk u kam thënë kthehuni. Nuk kam të drejtë t’u them kthehuni. Shkuarja e tyre është akt individual, kthimi i tyre është çështje ligjore, kushtetuese, institucionale”, ka deklaruar Kurti.

Ai ka thënë të enjten para deputetëve të Kuvendit, se të mërkurën në Bruksel nuk ka pasur marrëveshje, por pajtim për targat. “Marrëveshja e mbrëmshme nuk është marrëveshje për targat. Ne u morëm vesh t’i ndalojmë veprimet reciproke, pra ne nuk do të bëjmë gjë për targat KM dhe do t’i japim hapësirë negociimit të propozimit evropian, që më herët quhej franko-gjerman”, ka theksuar Kurti në seancën plenare të 24 nëntorit.

Kurti u ka thënë deputetëve se në takimin e së hënës i ishte ofruar një dokument me 95 fjalë, brenda të cilit propozimi franko-gjerman, apo propozimi evropian për çështjen e marrëveshjes për normalizim, nuk ka qenë i përfshirë në të. Ndërsa, sipas tij, tani situata është më ndryshe, “dhe është shumë mirë që tash gjithçka është përshpejtuar”. “Dakordimi i brendshëm ka një target kryesor dhe kohor për negociimin dhe pajtueshmërinë e palëve lidhur me propozimin e BE-së të mbështetur nga Franca dhe Gjermania, e ajo është sa më shpejt, dhe jo më vonë sesa fillimi i pranverës së vitit 2023”, ka theksuar Kurti.

Sipas tij, Kosova nuk e ka pranuar asnjë referencë në një marrëveshje konkrete që të përfshihet në tekstin e mbrëmshëm. “Kur unë kam qenë gjatë bisedimeve të hënës, insistimi më i madh ka qenë që në dakordimin që bëhet deklarata e Borellit të jetë Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe. Ata e shohin Asociacionin si thelb i normalizimit, ne e shohim njohjen reciproke si thelb i normalizimit. Është dallim i madh ndërmjet të hënës dhe të mërkurës”, ka thënë ai.

Në fjalën e tij, Kurti i është përgjigjur edhe kreut të PDK-së, Memli Krasniqi, i cili i ka thënë se duhet të jetë bashkëpunues me opozitën pasi që do t’i duhet bashkëpunimi edhe për marrëveshjen përfundimtare. “Unë as nuk mundem pa juve, as nuk dua pa juve”, i është përgjigjur Kurti, Krasniqit.

Në fillim të nëntorit, si pasojë e tensioneve të ngritura, serbët e veriut të Kosovës - ku qarkullojnë kryesisht makinat me targat të paligjshme - kanë dhënë dorëheqje nga institucionet e Kosovës.

Kthimin e tyre në institucione e kanë kërkuar edhe partnerët ndërkombëtarë.

Presidentit i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka thënë më 24 nëntor se përfaqësuesit serbë janë të gatshëm të kthehen në institucionet e Kosovës pasi të formohet Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe.

Për formimin e Asociacionit është rënë dakord me Marrëveshjen e Brukselit të vitit 2013 ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës, por kryeministri aktual i Kosovës, Albin Kurti, beson se komunat nuk mund të organizohen sipas parimeve etnike.

Pas arritjes së marrëveshjes për

targa, BE-ja tha se “palët e kuptojnë se të gjitha marrëveshjet e kaluara të arritura në bisedime duhet të zbatohen”, si dhe “çështjet dhe parimet kryesore që lidhen me normalizimin do të trajtohen në kontekstin e propozimit (e Brukselit)”, një nismë e cila u bë e njohur si propozimi franko-gjerman, i mbështetur nga Shtetet e Bashkuara.

Vuçiq: Targat KM do të mbeten

Presidentit i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka thënë se marrëveshja e arritur në Bruksel në mes të Kosovës dhe Serbisë për targat është një fitore e vogël taktike “që do të na çojë në presion edhe më të madh”.

Në konferencën për medie, Vuçiqi ka thënë të enjten se targat KM “do të mbeten dhe do të mbijetojnë” derisa negociatat janë duke vazhduar. Ai ka konfirmuar se nuk do të ketë targat të reja KM, të cilat, sipas tij, ishin rreth 90 sosh në vit. Vuçiqi, po ashtu, ka thënë se përfaqësuesit serbë janë të gatshëm të kthehen në institucionet e Kosovës pasi të formohet Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe. Në këtë mënyrë është përgjigjur Vuçiqi, i pyetur për qëndrimin në lidhje me zgjedhjet lokale në veri të Kosovës të planifikuara të mbahen më 18 dhjetor, pas largimit të serbëve nga veriu i Kosovës nga institucionet e Kosovës.

Edhe Lista Serbe e ka mirëpritur marrëveshjen e arritur në Bruksel dhe ka thënë se targat KM mbeten në përdorim dhe se ato do të mund të vazhdojnë, por “të reja nuk të lëshohen tani për tani”.

Çfarë janë pajtuar Kosova dhe Serbia për targat?

Negociatat janë zhvilluar në Bruksel më 23 nëntor mes të dërguarit të BE-së për dialogun, Miroslav Lajçak, dhe kryenegociatorëve të Kosovës dhe Serbisë, Besnik Bislimi dhe Petar Petković. Me marrëveshjen për targat, sipas kryediplomatit evropian, Josep Borell, Kosova do t’u japë fund veprimeve të mëtejme të lidhura me rirregjistrimin e makinave, derisa Serbia nuk do të lëshojë më targat të makinave me emra të qyteteve të Kosovës.

Hollësitë shtesë të marrëveshjes nuk janë bërë me dije, por kryenegociatori i Serbisë, Petar Petković, ka

thënë se me marrëveshjen e arritur mbeten në qarkullim tabelat KM (Mitrovicë e Kosovës), të cilat, sipas tij, do të mund t’i përdorin serbët në veri të Kosovës dhe nuk do të gjobiten për diçka të tillë. “Kjo do të thotë, ndër të tjera, se absolutisht të gjithë pronarët e makinave që kanë targat KM do të mund t’i regjistrojnë automjetet e tyre normalisht dhe ta zgjasin vlefshmërinë e targave KM. I vetmi vend ku do të ndalemi, do të ndalemi me lëshimin e targave fizike tërësisht të reja KM deri në momentin kur të gjejmë një zgjidhje përfundimtare për targat”, ka thënë Petković.

Tahiri: Kurti lëshoi pe, nuk dihet edhe sa kohë do të qarkullojnë targat ilegale

Ish-kryenegociatori i Kosovës për dialogun me Serbinë, Edita Tahiri, ka komentuar marrëveshjen e arritur për çështjen e targave në Bruksel. Tahiri nëpërmjet një shkrimi të publikuar në “Facebook” ka shkruar se Kurti ka lëshuar pe dhe se nuk dihet edhe sa kohë do të qarkullojnë targat ilegale në veri të vendit.

Ajo ka thënë se edhe këtë herë nuk u bë publike marrëveshja e arritur, duke theksuar se nuk dimë edhe

çfarë compromise të tjera ka bërë Kurti. “Marrëveshja për targat u arrit, Kurti lëshoi pe, tash nuk dihet edhe sa kohë do të qarkullojnë targat ilegale në veri të vendit, meqë nuk ka afat marrëveshje. Sikur të dëgjohehin amerikanët afati do të ishte 10 muaj. Prapë nuk u bë publike marrëveshja, nuk i dimë edhe çfarë compromise të tjera ka bërë Kurti si në të kaluarën. Por një gjë e dimë, Kurti as qeveria e tij nuk guxon të bëjë marrëveshje pa njohje reciproke me Serbinë. Nëse lëshon pe përballë do ta gjejë popullin e Kosovës, të cilin e njoh mirë, sepse është popull shembullor që di t’i mbrojë interesat kombëtare”, ka shkruar Tahiri.



Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe Konferenca e Rambujesë



Prof. dr. Paskal MILO

Në historinë moderne kombi shqiptar është ndeshur me shumë sfida mbijetese. Shumë prej tyre janë humbur. Ato që janë fituar janë pak. Por kanë qenë ato që kanë përcaktuar kursin e historisë shqiptare të shekullit XX, por edhe zhvillimet dhe gjendjen e botës shqiptare në dy dhjetëvjeçarët e parë të shekullit që jetojmë.

Një prej sfidave më të mëdha të kombit shqiptar dhe po aq betejë e fitore historike e jashtëzakonshme e tij ishte përmbyllja e pavarësisë shqiptare në kuptimin e shtrirjes territoriale të tij. Në vitin 1912 Shqipëria e pavarur ishte gjysma e territoreve shqiptare të banuara historikisht prej shqiptarëve. Gjysma tjetër e tyre u bënë të lira 87 vjet më vonë, në kapërcyell të shekullit, në vitin 1999 dhe të pavarura 96 vjet më vonë, në vitin 2008.

Betejat historike të shqiptarëve janë kushtëzuar nga një numër arsyes dhe faktorësh të cilat kanë përcaktuar humbjen apo fitoren e tyre. Ato kanë qenë të brendshme dhe të jashtme. Kur janë përputhur interesat e forcave kombëtare me ato ndërkombëtare ose të disa

aktorëve të fuqishëm botërorë, sfida shqiptare ka pasur sukses. Shqipëria u shpall e pavarur në vitin 1912, sepse u puqën interesat e Lëvizjes Kombëtare me interesat e Austro-Hungarisë dhe të Italisë.

Edhe në fundin e shekullit XX liria e Kosovës erdhi si rrjedhojë e një përputhjeje të interesave të shqiptarëve të Kosovës me interesat, në radhë të parë, me ato të Shteteve të Bashkuara, pastaj të Britanisë së Madhe e të disa vendeve të tjera evropiane. Pa këtë përputhje do të ishte utopi të arrihej ajo çfarë rezultoi në qershor 1999. Pa rolin udhëheqës të Shteteve të Bashkuara dhe ndërhyrjen e NATO-s, në mars - qershor 1999, Kosova nuk e fitonte lirinë. Kjo është njëra aksiomë që del nga analiza historike. Aksioma e dytë është se pa rezistencën e gjithanshme të shqiptarëve të Kosovës dhe luftën kryengritëse të Ushtrisë Çlirimtare liria e pavarësia e saj do të mbetej një objektiv i bukur, fisnik, frymëzues, por i paarritur. Liria nuk dhurohet, por fitohet.

Këto janë kornizat e analizës për temën. Brenda tyre në fokus do të jetë roli i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), i cili në tërësinë e tij ka tre

momente: i pari në organizimin, forcimin dhe në imponimin e UÇK-së për të dalë si faktor përcaktues në terrenin e luftimeve, aq sa e detyroi edhe komunitetin ndërkombëtar ta njohë si të tillë; i dyti këmbëngulja e UÇK-së në negociatat e kështjellës së Rambujesë që ishte epike, por jo e strukturuar; që ishte luftarake, por jo diplomatike; që ishte dyshuese e mosbesuese, por vendimtare për arritjen e marrëveshjes; i treti në finalizimin e luftës çlirimtare e në bashkërendimin e saj me ndërhyrjen e forcave të NATO-s.

Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe Konferenca e Rambujesë nuk mund të kuptohen pa njëra-tjetrën. Vendimi që morën vendet anëtare të Grupit të Kontaktit (Shtetet e Bashkuara, Britania e Madhe, Franca, Gjermania, Italia dhe Rusia), më 29 janar 1999, për të organizuar një konferencë ndërkombëtare për Kosovën, nuk mori shkas vetëm nga masakra e Reçakut që kishte ndodhur dy javë më parë. Kjo masakër ishte pika fundore e politikës së dhunës e të gjenocidit të regjimit të Millosheviqit për ta mposhtur rezistencën dhe luftën e shqiptarëve për liri. Ajo

paralajmëronte fare qartë se verbëria shoviniste e Beogradit rrezikonte të shkaktonte një Srebrenicë të dytë. Qëllimi final i regjimit të Beogradit ishte eliminimi i UÇK-së, e vetmja forcë e aftë dhe e vendosur për ta ndaluar masakrimin e shqiptarëve e për ta udhëhequr luftën e tyre të armatosur kundër sundimit serb.

Vendimi për ta organizuar Konferencën Ndërkombëtare të Rambujesë ishte një sfidë më vete, me shumë të panjohura, por që mes tyre kishte dy më kryesoret: pjesëmarrjen e shqiptarëve dhe të regjimit të Beogradit. Shtetet e Bashkuara dhe në përgjithësi Grupi i Kontaktit Konferencën e Rambujesë e konceptuan sipas modelit të Konferencës së Dejtonit për Bosnjën, të vitit 1995, negociata intensive brenda një kohe të shkurtër (një javë) me përqendrim diplomatik të nivelit të lartë (ministrat e jashtëm). Deklarata e Grupit të Kontaktit ishte ultimative dhe ajo kërkonte të gjendej një formulë kompromisi bashkëjetese midis serbëve dhe shqiptarëve brenda çatisë së Republikës së mbetur Federative të Jugosllavisë. Parashihej që shqiptarëve t'u ofrohej një status autonom i

zgjerruar.¹ Shqiptarët e Kosovës u gjenden para një situatë sa historike aq dhe delikate. Nuk ishte e thjeshtë që të merrej një vendim kaq madhor kur nuk kishte garanci, kur nuk premtohet realizimi i objektivit final - liria dhe pavarësia. Shqiptarët ndodheshin para një dileme hamletiane: të shkonin apo të mos shkonin në Rambuje. Zëra të njohur të politikës mbarëshqiptare, Adem Demaçi në Prishtinë dhe Sali Berisha në Tiranë, vajtjen në Rambuje e quajtën tradhti kombëtare.

Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian u angazhuan fuqimisht për t'i sjellë palët në Rambuje. Më 2 shkurt 1999 Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Lëvizja për Bashkimin Demokratik u deklaruan në favor të pjesëmarrjes në Konferencën e Rambujesë. Por vendimtar ishte reagimi i UÇK-së dhe aty u përqendruan në mënyrë të veçantë edhe përpjekjet e amerikanëve. Uashingtoni, por edhe të tjerë, iu drejtuan për ndihmë edhe Qeverisë Shqiptare, fjala e së cilës dëgjohej me vëmendje. Presidenti i Republikës, kryeministri dhe ministri i

Jashtëm biseduan intensivisht me përfaqësuesit e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK në krye me Hashim Thaçin që u gjendeshin në Tiranë. Në pasditen e 2 shkurtit, zëdhënësi i UÇK-së shpalli vendimin e Shtabit të Përgjithshëm për të shkuar në Konferencën e Rambujesë.² Më 4 shkurt edhe Beogradi mori vendimin për ta dërguar delegacionin e tij në Konferencë.

Konferenca e Rambujesë u hap më 6 shkurt pasdite. Në emër të Grupit Kontaktit delegacioneve shqiptare e serbe iu shpërnda "Korniza e Marrëveshjes së Përkohshme për Paqe e Vetëqeverisje në Kosovë" si projekt bazë për diskutimet. Ajo u njoh ndryshe edhe si Marrëveshja Kuadër.³

Qëllimi i këtij kumtimi nuk është përshkrimi i punimeve të Konferencës së Rambujesë. Janë shkruar shumë libra rreth saj, nga shqiptarë e të huaj. Objekti është më i ngushtë në tematikë, por thelbësor në përmbajtje: roli i UÇK-së në Konferencë. UÇK-ja aty ishte objekt, por ishte edhe subjekt. Në thelb, Konferencën e Rambujesë e diktoi lufta e UÇK-së, pra aty do të gjykohej për rolin e saj e do të vendosej rreth saj. Por, UÇK-ja ishte edhe e përfaqësuar në Konferencë me pesë anëtarë të delegacionit shqiptar: Hashim Thaçin, drejtorin politik të saj, Jakup Krasniqin, zëdhënësin e saj, Azem Sylën, Ram Bujën dhe Xhavit Halitin. Nuk ishte rastësi që Hashim Thaçi u zgjodh kryetar i delegacionit shqiptar në Konferencë. Për asnjë meritë tjetër të tij veç asaj që ishte një nga drejtuesit e UÇK-së.

UÇK-ja u vendos në qendër të punimeve të Konferencës, por edhe të diplomacisë dhe të medias ndërkombëtare. Ajo u bë objekt analizash të burokracive diplomatike jo vetëm të gjashtë qeverive të vendeve të Grupit të Kontaktit, por shumë më gjerë, të vendeve evropiane, rajonale, të NATO-s, të Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Jo vetëm Madeleine Albright, që kishte informacionin më të plotë e më cilësor, por edhe kryediplomatë të tjerë si sekretari i jashtëm britanik Robin Cook, ministri i Jashtëm francez Huber Vedrin, gjermani Joshka Fischer, italianii Lamberto Dini e të tjerë erdhën në Rambuje me dosje të plotësuar me studime dhe analiza për UÇK-në dhe drejtuesit e saj. Dhe jo vetëm kaq, por dhe me paragjykim, sidomos dy-tre prej tyre, të cilët, në një mënyrë ose një tjetër, reflektonin dhe lidhjet tradicionale të vendeve të tyre me Serbinë dhe Jugosllavinë e mbetur. Ministri i Jashtëm i Rusisë, Igor Ivanov dhe përfaqësuesi i posaçëm rus në Rambuje, Boris Majorski, ishin

të rreshtuar në Grupin e Kontaktit më tepër për të ndikuar në relativizimin e goditjeve të forta perëndimore ndaj regjimit të Millosheviqit sesa të kërkonin zgjidhje realiste të konfliktit në Kosovë. UÇK-në ata e shihnin dhe e vlerësonin me syzet e Beogradit.

Ballafaqimi i UÇK-së, por dhe i gjithë delegacionit shqiptar të Kosovës në përbërje të të cilit ishin emra elitare të politikës dhe inteligjencës kosovare si Ibrahim Rugova, Rexhep Qosja, Fehmi Agani, Idriz Ajeti, Bujar Bukoshi, Hidajet Hyseni, Bajram Kosumi, Veton Surroi, Blerim Shala etj. me delegacionin serb, por edhe me Grupin e Kontaktit, ishte një sfidë shumë e madhe, e frikshme, por edhe e rrezikshme. UÇK-ja, por dhe i gjithë delegacioni shqiptar, nuk kishin as kulturë të veçantë diplomatike, as njohuri bazë të së drejtës ndërkombëtare, por as përvojë negociimi. Përkundrazi, delegacioni serbo-jugosllav ishte një ekip i kompletuar, me ekspertë të njohur dhe me një shkollë trajnimit negociues, siç kishte qenë Konferenca e Londrës e vitit 1992 për ish-Jugosllavinë dhe Konferenca e Dejtonit për Bosnjën në vitin 1995. Në qarqet diplomatike amerikane dhe evropiane, këto rrethana, por dhe diferenca ishin të njohura dhe aty-këtu ishin shfaqur edhe dyshimet e një frymë skeptike. Edhe vetë drejtuesit e UÇK-së e të delegacionit shqiptar ishin të ndërgjegjshëm dhe realistë për këtë mangësi ndaj edhe kërkuar ndihmë në ekspertizën e të drejtës ndërkombëtare e kushtetuese si dhe në teknikat negociuese diplomatike.

Ndihma në radhë të parë erdhi nga Shtetet e Bashkuara. Ish-zyrtarë dhe diplomatë të nivelit të lartë nga Departamenti i Shtetit, juristë dhe ekspertë të së drejtës, u angazhuan si këshilltarë pranë delegacionit shqiptar. Përfaqësues të diasporës shqiptare të njohur e të specializuar në fushat e mësipërme u vendosën në dispozicion të delegacionit. Shqipëria angazhoi ekspertizën e saj më të mirë juridike në të drejtën ndërkombëtare e kushtetuese për konsultime e mendime për Marrëveshjen Kuadër që ishte dorëzuar në fillim të Konferencës e për të gjitha çështjet në vijimësi. Ajo dërgoi përfaqësuesit e saj zyrtarë dhe krijoi grupin e punës në Paris në mbështetje të delegacionit shqiptar. Rol që nga fillimi e deri në fund luajti edhe ambasada shqiptare në kryeqytetin francez. Vetë ministri i Punëve të Jashtme i Qeverisë Shqiptare në dy momentet finale të Konferencës u ndodh pranë delegacionit shqiptar për ta



përcjellë mbështetjen e fuqishme të shtetit shqiptar.

Korniza e Marrëveshjes së Përkohshme për Paqe dhe Vetëqeverisje në Kosovë që iu shpërnda të dy delegacioneve në emër të Grupit të Kontaktit ishte një dokument i hartuar me shumë kujdes e frymë kompromisi. Ai përmbante disa kapituj ku trajtohehin parime të përgjithshme, çështjet e sigurisë, të institucioneve vetëqeverisëse në Kosovë, të pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv. Në këtë projekt-marrëveshje parashikohej që garante për zbatimin e saj do të ishin forcat ndërkombëtare që do të vendoseshin në Kosovë. Gjithashtu, aty theksohej se pas tre vjetësh që cilësohej si periudhë kalimtare, kjo marrëveshje do të rishikohej dhe do t'i bëhej një vlerësim tërësor nën kujdesin ndërkombëtar me qëllimin për ta përmirësuar zbatimin e saj dhe për të përcaktuar nëse vënia në jetë i propozimeve do të kërkonte hapat plotësuese nga çdo anë.⁴ Delegacioneve iu la dy ditë afat për ta studiuar e diskutuar projekt-marrëveshjen e për t'i paraqitur mendimet e tyre në treshen e negociatorëve ndërkombëtarë: Kristofer Hill, Volfgang Petritsch dhe Boris Majorski.

Shqyrtimi i dokumentit të Grupit të Kontaktit nga delegacioni shqiptar nxori mangësi dhe paqartësi rreth përcaktimit të statusit të Kosovës, çështjes së organizimit të referendumit në përfundim të periudhës kalimtare trevjeçare dhe fatit të UÇK-së. Formulimi i statusit të Kosovës ishte lënë qëllimisht jashtë tekstit të Marrëveshjes Kuadër, sepse ajo mund ta komprometonte që në fillim suksesin e Konferencës. Aty vetëm se ishte përmendur disa herë parimi i vetëqeverisjes në kuadrin e të drejtave të minoriteteve për të marrë pjesë aktive në qeverisjen e Kosovës e në

ushtrimin e lirive dhe të drejtave demokratike. Në dokument nënvizohej se këto liri dhe të drejta të komuniteteve nacionale nuk duhej ta cenonin sovranitetin shtetëror dhe integritetin territorial të Republikës Federale të Jugosllavisë.⁵

Delegacioni shqiptar, veçanërisht përfaqësuesit e UÇK-së, që në fillim reagues se në projekt-marrëveshje mungonte klauzola e referendumit për statusin e ardhshëm të Kosovës, si dhe ajo për fatin e UÇK-së. Këto dy çështje do të bëheshin boshti qendror rreth të cilave do të vërtitej e gjithë veprimtaria e delegacionit shqiptar. Nëse për çështjen e parë kishte konsensus të shprehur nga të gjithë anëtarët e delegacionit, për çështjen e dytë, për fatin e UÇK-së, interesimi ishte fragmentar, i një pjese të delegacionit, i përfaqësuesve të UÇK-së dhe i atyre të LBD-së. Hashim Thaçi si kryetar i zgjedhur i delegacionit dhe si përfaqësues i UÇK-së ushtroi ndikim dhe udhëheqje që jo gjithnjë gjeti mirëkuptimin e anëtarëve të tjerë, veçanërisht atyre të LDK-së. Gjithsesi delegacioni e ruajti unitetin dhe në reagimin e tij të parë me shkrim, projekt-marrëveshja u gjykua e pranueshme, por u shoqërua me disa kërkesa, ku dy ishin më kryesoret: ideja e referendumit në fund të periudhës kalimtare dhe e ardhmja e UÇK-së.⁶

Delegacioni serbo-jugosllav në dukje shfaqej i qetë dhe nuk ishte i interesuar për t'u ulur në negociata thelbësore. Taktika e tij gjatë javës së parë ishte të fitonte kohë, negociatat të zvarriteshin deri në dështimin e tyre. Për këtë qëllim ai refuzonte të bënte komente për projektin e Marrëveshjes Kuadër për ato pjesë që i ishin dhënë duke pretenduar se ato do të bëheshin në momentin kur do t'u jepeshin në

dispozicion dhe kapitujt e sigurisë e të policisë. Me objektiv zvarritjen e procesit, por edhe për ta ndryshuar kursin e tij, serbo-jugosllavët propozuan që të dyja palët ta nënshkruanin paraprakisht paketën me dhjetë parimet bazë të Marrëveshjes Kuadër të cilat ishin të përgjithshme dhe nuk cenonin drejtpërsëdrejti interesat e tyre në Kosovë. Por kjo përpjekje e Beogradit u kuptua menjëherë nga ndërmjetësuesit amerikanë dhe evropianë. Ambasadori Hilli, në lidhje me këtë, atëbotë deklaroi se "kjo strategji e delegacionit serb, për ta nënshkruar deklaratën e dhjetë parimeve pa përfundimin e Marrëveshjes finale, synon ta minojë Rambujenë. Filozofia jonë është që asgjë e veçantë nuk duhet pranuar pa u pranuar e gjitha".⁷ Në thelb, delegacioni serbo-jugosllav nuk kishte mandat për të vendosur. Gjithçka ishte e përqendruar në Beograd, në duart e Millosheviqit.

Një javë pas fillimit të Konferencës së Rambujesë, ashtu siç dhe pritej, nuk pati ndonjë përparim për t'u shënuar. Ministri i Jashtëm të Grupit të Kontaktit, më 14 shkurt, në mbledhjen e tyre të parashikuar, vendosën për zgjatjen edhe për një javë të Konferencës, deri më 20 shkurt. Në konkluzionet e kësaj mbledhjeje, Grupi i Kontaktit i ftoi të dy delegacionet që të shfrytëzonin ditët në vijim për të arritur një marrëveshje të shpejtë mbi bazën e propozimeve për vetëqeverisje në Kosovë. Duke e ndier rrezikun e dështimit, Shtetet e Bashkuara ndërmorën një ofensivë intensive diplomatike për t'i ulur palët në tryezë për ta nënshkruar marrëveshjen. Vetë presidenti Bill Klintoni paralajmëroi një ditë para mbledhjes së Grupit të Kontaktit, më 13 shkurt, se "në qoftë se Serbia nuk i përmbush angazhimet e saj të mëparshme për tërheqjen e trupave dhe nuk

e mbështet marrëveshjen e paqes, NATO-ja është e autorizuar të kryejë sulme ajrore kundër saj. Në të njëjtën kohë, ne ua kemi bërë të qartë shqiptarëve të Kosovës se nëse ata e kundërshtojnë planin tonë ose vazhdojnë luftën, ata nuk do të kenë mbështetje nga ne”.⁸

Madeleine Albrighti, në vijim të deklaratës së presidentit Klinton, për herë të parë në Rambuje arriti që drejtuesit e të dy delegacioneve t'i ulte në një tavolinë dhe t'u përcillte qartë si mesazhet e presidentit amerikan ashtu edhe ato të Grupit të Kontaktit. Këto mesazhe ajo ua dha në një takim të veçantë drejtuesve të delegacionit shqiptar Hashim Thaçit, Ibrahim Rugovës e Rexhep Qosjes.

U vendos që ndërmjetësuesi amerikan Hill, i shoqëruar nga drejtorët politikë të Ke D'Orseje e të Forin Ofisit, më 16 shkurt të shkonin në Beograd e ta takonin Millosheviqin. Ky takim u parashoqërua nga një bisedë telefonike e Albrightit me të. Njëkohësisht në rrugë jozyrtare delegacionit serbo-jugosllav iu dorëzua teksti i plotë i projekt-marrëveshjes së bashku me aneksin e sigurisë.

Këto veprime e rivendosën procesin në lëvizje. Më 16 shkurt delegacioni serbo-jugosllav dorëzoi komentet për tre kapitujt e parë të projekt-marrëveshjes që i ishin dorëzuar zyrtarisht që në fillim të Konferencës. Përfundimi, shkruan ndërmjetësuesi austriak i Bashkimit Evropian, ambasadori Petritsch “ishte zhgënjyes: në të hidheshin poshtë disa pjesë thelbësore të marrëveshjes duke u zëvendësuar me formulime krejt të reja... Ky qëndrim nuk ishte aspak i frytshëm për vazhdimin pozitiv të Konferencës”.⁹ Këto lëshime u bënë për ta joshur Beogradin.

Më 18 shkurt Konferenca hyri në fazën e saj përfundimtare. Grupi i Kontaktit këtë ditë ua shpërndaui të dy delegacioneve një projekt të dytë të Marrëveshjes Kuadër, përfundimtar me ndryshime të rëndësishme në favor të Serbisë e të Jugosllavisë. Delegacioni shqiptar u shokua nga ky projekt. Vite më vonë, një anëtar i tij, Blerim Shala, do të kujtonte: “Të gjithë anëtarët e Delegacionit, tejet të lodhur, të frustruar, nervozë, ndiheshin edhe të mashtruar e të manipuluar, sepse e tërë puna jonë, posaçërisht e Grupit Politik e dhjetë ditëve të kaluara, kishte shkuar huq”.¹⁰ Hutimi dhe zemërimi ia la vendin arsytimit dhe përgatitjeve të Deklaratës në emër të Delegacionit që e kundërshtonte projektin e ri të Marrëveshjes Kuadër. Deklarata e quante atë të papranueshëm.¹¹



Gjithçka rrezikonte të kthehej në pikën zero. Shqiptarët e Kosovës aq sa kishin shansin për të fituar po kaq edhe rrezikoheshin që ta humbnin mbështetjen amerikane dhe atë ndërkombëtare me këmbënguljen e tyre për të fituar gjithçka që synonin në Konferencën e Rambujesë. Por, edhe për Shtetet e Bashkuara, Konferenca ishte një sfidë që duhej fituar. Burime diplomatike të kohës pohuan se Madeleine Albright po jetonte “çastet më të vështira që nga koha kur ishte emëruar sekretare shteti”.¹² Nuk ishte një sfidë vetëm personale, por vihej në dyshim edhe efikasiteti i politikës së jashtme amerikane, aftësia e saj për të ndërhyrë e zgjidhur krizat, pa folur për rrjedhojat ndërkombëtare të një dështimi të mundshëm. Në Uashington të gjitha u morën në konsideratë dhe u diskutuan. Albright, më 20 shkurt, që ishte dhe dita e fundit e Konferencës, erdhi dhe u ngul në Rambuje. Ajo takoi e ritakoi delegacionin shqiptar në përpjekje për ta bindur për ta nënshkruar marrëveshjen, u bëri sqarime e u dha garanci, u premtoi mbështetje por edhe paralajmëroi se Kosova mund t'i humbiste Shtetet e Bashkuara e dihej se cilat mund të ishin rrjedhojat.

Në përfundim të këtij kalvari bisedimesh në Kështjellë u sqaruan disa çështje, por dy më kryesoret, ato për referendumin në fund të periudhës kalimtare dhe për të ardhmen e UÇK-së, nuk qe e mundur të gjendej konsensusi. U propozuan formulime alternative për fjalën “referendum” e “vullnet i popullit”, u propozua një letër garancie nga Hilli e më vonë nga Albrighti për angazhimin amerikan për zbatimin e marrëveshjes, por jo të gjithë

anëtarët e Delegacionit u bindën, veçanërisht Thaçi. Nga komandantët e UÇK-së në terren ishin përhapur zëra kërcënues dhe Adem Demaçi në Lubjanë u bë zëdhënës i tyre. Hashim Thaçi e ndjeu presionin e tyre dhe më 19-20 shkurt shkoi në Lubjanë, bisedoi me Demaçin por, pa rezultat. U kthye në Rambuje i pasigurt dhe i frustruar, i ngurtësuar dhe jo i gatshëm për ta nënshkruar marrëveshjen.

Për të fituar kohë, Shtetet e Bashkuara ndërhyrën dhe zgjatën edhe tri ditë të tjera Konferencën, deri më 23 shkurt në mesditë. Ndërkohë që vazhdoi të punojë me Hashim Thaçin e delegacionin shqiptar, sekretarja e Shtetit kërkoi ndihmën urgjente të Qeverisë Shqiptare. Më 21 shkurt në mbrëmje dhe ditën tjetër paradite Albrighti bisedoi dy herë me kryeministrin Majko dhe ministrin e Jashtëm, ndërkohë që Kristopher Hilli ishte në kontakt të vazhdueshëm. Kërkesa e tyre ishte “që edhe një herë tjetër urgjentisht ta përdornim influencën tonë te Thaçi dhe djemtë e tjerë të UÇK-së për t'i bindur”.¹³ Sekretarja e Shtetit informoi se i kishte dërguar një projekt-letër delegacionit shqiptar në të cilën bënte interpretimin e paragrafit 8, pika 1, që bënte fjalë për një mbledhje ndërkombëtare në fund të periudhës kalimtare trevjeçare, ku do të shqyrtohej mekanizmi për ta përcaktuar statusin final të Kosovës duke marrë parasysh vullnetin e popullit. Ky formulim, sqaronte në atë kohë sekretarja e Shtetit, “u jep të drejtën shqiptarëve të kërkojnë referendumin pas tre vjetësh”.¹⁴ Edhe për të ardhmen e UÇK-së, e cila, sipas Petritschit, ishte “arsyeja e vërtetë e intrasigjencës

kosovare”, amerikanët kishin ofruar formula të transformimit të saj në parti politike apo në forcë sigurie, u kishin sjellë ekspertë për t'i shpjeguar këto organizime. Por nuk kishin mundur t'i largonin dyshimet as të Hashim Thaçit dhe as të UÇK-së.

Qeveria shqiptare, duke vlerësuar maksimalisht rëndësinë e jashtëzakonshme të vendimit të delegacionit shqiptar në Rambuje për të ardhmen e Kosovës, vendosi ta dërgojë urgjentisht aty ministrin e Jashtëm të saj, të shoqëruar nga kryetari i Komisionit të Jashtëm të Kuvendit, Sabri Godo. Ndërkohë presidenti i Republikës, Rexhep Meidani dhe shkrimtari Ismail Kadare i dërguan letra personale delegacionit shqiptar në Rambuje në të cilat u bënin thirrje anëtarëve të tij që ta kuptonin plotësisht momentin historik në të cilin ndodheshin e ta nënshkruanin marrëveshjen.

Faza finale e Konferencës ishte me të vërtetë dramatike. Delegacioni shqiptar ndodhej para përgjegjësive historike që nuk mund të përshkruhet me fjalë. Por në momentet e fundit e gjithë barra e vendimmarrjes rëndoi vetëm mbi një emër: Hashim Thaçin “mbi tridhjetëvjeçarin pa përvojë në politikë rëndonte një përgjegjësi gjigante”, do të shkruante pak vite më vonë ndërmjetësuesi i BE-së, Petritsch.¹⁴ Thaçi ishte i zgjuar, luftarak, kokëfortë, por edhe shumë konspirativ. As nuk e kuptojë në vështrimin e parë, as në fillim kur ai ta jepte përshtypjen e një njeriu timid, as edhe në fund të bisedës kur e njëjta fytyrë nuk shprehte asgjë dhe me kursim mund të konfiguronte një buzëqeshje të lehtë. Ky ishte Hashim Thaçi i fasadës. Thelbi i tij ishte krejt tjetër: vullnet deri në ekstrem

për t'i arritur objektivat e tij, dyshues, nervoz deri në fund kur i mbaronin argumentet, por shumë i vëmendshëm e miqësor atje ku e lypte interesi ose në adresë të atyre që fitonin besimin e tij.

Thaçi në ato ditë shkurti jetonte në vorbullën e mendimeve, llogarive e sugjerimeve kontradiktore, të presioneve e të kërcënimeve që i vinin nga komandantët e UÇK-së në Kosovë, por dhe nga mbështetës e sponsorë të diasporës në Perëndim. Përtej çështjes madhore kombëtare, në lojë ishte dhe fati i tij personal. Nga ana tjetër, tek ai përplasej presioni i madh amerikan. Administrata e Bill Klintonit, vetë presidenti, sekretarja e Shtetit, CIA, NATO e të tjerë nuk mund të praninin që realizimi i objektivave të tyre strategjike në rajon të merreshin peng nga një individ, deri disa muaj më parë krejtësisht i panjohur. U përdorën të gjitha mjetet dhe mënyrat, të buta e të forta, premtime të afërta e të largëta për ta joshur e për ta bindur. Amerikanët shpeshherë kanë shtrënguar dhëmbët në adresë të tij dhe autori i këtyre radhëve ka qenë i pranishëm ose i ka dëgjuar artikulumet plot zemëratë apo kërcënime e përfaqësuesve të lartë diplomatikë amerikanë ndaj tij.

Në Konferencën e Rambujesë as Hashim Thaçi dhe as UÇK-ja nuk ishin instrumente në duart e Shteteve të Bashkuara siç mendohej në Beograd, Moskë apo gjetiu apo siç aludohej nga kritikët mediatikë ndërkombëtarë. Përkundrazi, Hashim Thaçi dhe UÇK-ja u sollën shumë kokëçarje amerikane në fazën finale të Konferencës së Rambujesë. Jo të gjithë e dinë e jo të gjithë kanë dashur që ta pranojnë këtë të vërtetë. Ministri i Jashtëm i

Gjermanisë, Joshka Fisherit, që në këtë kohë ishte edhe kryetari i K.M të BE-së, e ka pohuar këtë fakt vite më vonë kur shkruante se “ShBA-ja nuk kishte në anijen e vet shqiptarët e Kosovës apo se ata do të lëviznin pas çdo fishkëllime që vinte nga Uashingtoni... U dëshmuua se kundërshtimi i delegacionit të shqiptarëve të Kosovës, me gjithë fjalët e mira, lutjeve dhe kërcënimeve nga ana e delegacioneve perëndimore dhe disa ministrave të jashtëm, ishte i patejkalueshëm”.¹⁵

Në këto rrethana të jashtëzakonshme, delegacioni shqiptar nga Tirana, i kryesuar nga ministri i Jashtëm, arriti në Rambuje. Ishte dita e fundit e Konferencës.

Madeleine Albrighti ishte në alarm. Një natë më parë ajo deri në mesnatë ishte përpjekur ta thyente rezistencën e Thaçit por, pa sukses. Kishte arritur që me një gjuhë sa ultimative, por edhe dëshpëruese, t'i shqiptonte fjalët: nëse nuk do të kishte marrëveshje ajo do ta harronte fjalën Kosovë! Hilli dhe ndihmësit e tij në Kështjellë ishin të rraskapitur pas 48 orë pa gjumë e po bënë përpjekjet e fundit por, pa shumë shpresë. Kishte rënë hija e rëndë e dështimit të Konferencës. Delegacioni i shqiptarëve të Kosovës brenda në Konferencë ishte i mpirë dhe i pafuqishëm për të ndryshuar ndonjë gjë. Dy takime dramatike, njëri në orën 8.00 të mëngjesit, tjetri në orën 13.00 të ministrit të Jashtëm shqiptar e të zotit Sabri Godo me katër anëtarë të delegacionit të shqiptarëve të Kosovës brenda ambienteve të Kështjellës, ishin shpresa e fundit. Në takime erdhën Hashim Thaçi, Rexhep Qosja, Azem Syla dhe Veton Surroi. Se çfarë u tha e u bisedua aty në përgjithësi është bërë e njohur. Takimi i parë nuk solli ndonjë ndryshim në qëndrimin e Thaçit, ndërkohë që Qosja, Surroi dhe Syla mbështetën nënshkrimin e marrëveshjes. Me kërkesën e ministrit të Jashtëm shqiptar, Hilli organizoi një takim të dytë me Thaçin dhe bashkëshoqëruesit e tjerë të takimit të parë. Ambasadori amerikan ishte në kufijtë kritikë të nervozizmit dhe i lejoi vetes një shpërthim akuzash e kërcënimesh në adresë të Thaçit në takimin me ministrin e Jashtëm shqiptar.

Takimi i dytë kishte shumë emocione. Ishte përpjekja e fundit. Pritej vetëm përgjigja e delegacionit shqiptar. Përsëri të njëjtat argumente. Veç me një ndryshim taktik: “bombardimi” i Thaçit nga pikëpamja psikologjike rreth përgjegjësisë së tij ndaj kombit shqiptar, Shqipërisë dhe rrezikut të humbjes përfundimisht të miqësisë e të aleancës me Shtetet e Bashkuara në këto

kohë vendimtare. Kjo “kryqëzatë” psikologjike në kështjellën mesjetare franceze, e kombinuar me dy telefonata nga Tirana prej kryeministrit Majko, më në fund çuan në fjalët e Thaçit me peshë historike: “Më lejoni të shkoj gjysmë ore në dhomë e të marr një vendim”. Mesazhi që përcollën këto fjalë, sytë e Hashim Thaçit dhe buzëqeshja e tij disi enigmatike, e përcollën vendimin e tij që aty ku u bë takimi i dytë, në palestrën e shkollës së Rambujesë, një “Po” në parim që do të kthehej rreth dy orë më vonë me vendim që delegacioni shqiptar do ta firmoste Marrëveshjen dy javë pas konsultimeve që do të bëheshin me popullin në Kosovë. Si garanci, delegacioni shqiptar dorëzoi një letër tek amerikanët me firmën e sekretarit të tij Veton Surroi.

Kjo është, me pak fjalë, historia e pjesës së parë dhe kryesore e Konferencës së Rambujesë dhe i rolit të UÇK-së aty. Ajo nuk ka pretendimin se ka konsumuar të gjitha aspektet e saj. Kjo do të ishte e pamundur dhe jo e ndershme, sepse kontributorët nuk kanë qenë pak dhe të gjitha çështjet e tjera të rëndësishme. Pjesëmarrës të Konferencës, shqiptarë dhe të huaj, kanë botuar libra rreth saj, por jo të gjithë janë treguar objektivë, të paktën për ta njohur kontributin e jashtëzakonshëm të Qeverisë Shqiptare në fazën përfundimtare të saj. Nihilistëve shqiptarë, në Prishtinë e në Tiranë, mund t'u paraqiten mjaft dëshmi dokumentare të kohës e të huaja, amerikane, britanike, franceze etj. që e vlerësojnë me terma realistë këtë kontribut. Por mjafton vetëm një prej tyre, i njërit prej tre ndërmjetësuesve ndërkombëtarë, i atij që përfaqësonte Bashkimin Evropian në Rambuje, ambasadorit Wolfgang Petritsch: “Qeveria shqiptare dhe ministri i saj i Jashtëm vepruan me shumë përgjegjësi dhe profesionalizëm. Tirana kishte adaptuar një politikë shumë të përgjegjshme në mbështetje të strategjisë së Perëndimit për paqen përmes negociatave. Në këtë mënyrë ata i bënë një shërbim të madh komunitetit ndërkombëtar, i cili donte ta zgjidhte konfliktin sipas çështjeve të rena dakord më parë në Grupin e Kontaktit”.¹⁶

Në parim, fitorja e UÇK-së dhe disfata e regjimit të Millosheviqit u vendos në Rambuje. Por ajo nuk ishte e plotë edhe e sigurt për sa kohë që nuk ishte marrë mbështetja brenda në Kosovë, veçanërisht e strukturave komanduese rajonale të UÇK-së. Ndaj edhe udhëheqjes së UÇK-së në Rambuje iu dha tri javë kohë që të kuvendonte me komandantët

e saj të terrenit dhe me shqiptarët që e mbështetnin atë. Ishte një sfidë tjetër që duhej përballuar. Amerikanët u bënë pas Rambujesë edhe më bashkëpunues me Qeverinë Shqiptare për ta siguruar mbështetjen e brendshme kosovare në favor të Marrëveshjes. Hilli dhe ambasadorja në Tiranë, Mariza Lino, ishin non-stop në komunikim me Qeverinë Shqiptare. Madeleine Albrighti i duhej një “Po” e sigurt e shqiptarëve deri më 8 mars, ditë kur ajo do të dilte para Kongresit Amerikan. Hashim Thaçi herë shfaqej e herë zhdukej nga Tirana në ato ditë të para të marsit, e kërkonin të gjithë, por ai punonte me komandantët në terren. Amerikanët ishin ende mosbesues ndaj tij pas asaj sjelljeje enigmatike në Rambuje dhe frika ishte se mos, i ndodhur nën presionin e komandantëve të UÇK-së në rajonet e Kosovës, tërhiqej nga angazhimet që mori në Rambuje e sidomos nga ai i çmilitarizimit të UÇK-së. Shumë biseda diplomatike janë konsumuar për këtë temë mes Qeverisë Shqiptare dhe përfaqësuesve të Departamentit të Shtetit. Atë që amerikanët nuk mund ta bënin publikisht, e bëri partneri i tyre më i madh e më besnik, kryeministri britanik Toni Bleri, kur më 8 mars paralajmëroi se “kosovarët duhet ta kuptojnë se ka ardhur koha që Ushtria Çlirimtare e Kosovës t'i ndërpresë operacionet dhe të pranojë të çarmatoset”.¹⁷

UÇK-ja hapi dritën jeshile për miratimin e Marrëveshjes. Tashmë shqiptarët e Kosovës e kishin kryer detyrën e tyre para historisë, por edhe para Grupit të Kontaktit e komunitetit ndërkombëtar. Në emër edhe të saj, më 14 mars Hashim Thaçi u dërgoi letra garancie sekretares së Shtetit, Madeleine Albright, bashkëkryetarëve të Konferencës Ndërkombëtare, Robin Cook e Hyber Vedrin, si dhe kryetarit të K.M. të BE-së, ministrit të Jashtëm gjerman Joshka Fischer. Ditën tjetër, më 15 mars, në Qendrën Ndërkomb-

ëtare Kleber në Paris, Grupi i Kontaktit rifilloi negociatat me delegacionin serbo-jugosllav i cili paraqiti 20 faqe vërejtje për tekstin e projekt-marrëveshjes. Ishte një përpjekje e fundit, por edhe e dështuar e delegacionit serbo-jugosllav për të fituar kohë e për ta zvarritur nënshkrimin e marrëveshjes. Nuk kishte më vesh në Grupin e Kontaktit për t'i dëgjuar. Më 18 mars, në Qendrën Ndërkombëtare Kleber, u nënshkrua Marrëveshja e Përkohshme për Kosovën. Nga delegacioni shqiptar nënshkruan Hashim Thaçi, Ibrahim Rugova, Rexhep Qosja dhe Veton Surroi. Të pranishëm ishin edhe negociatorët ndërkombëtarë të Grupit të Kontaktit, Hill, Petritsch dhe Majorski. Dy të parët e nënshkruan Marrëveshjen, rusi Majorski jo.

Konferenca e Rambujesë u mbyll. Shqiptarët dolën fitimtarë. Por duhet pohuar pa mëdyshje se faktori kryesor në suksesin e shqiptarëve në Konferencë ishte UÇK-ja. Rambujeja dhe UÇK-ja ishin binomi që garantoj suksesin diplomatik e politik, themeli i luftës që çoi në çlirimin e Kosovës dhe në pavarësinë e saj. Ndërhyrja e NATO-s në Kosovë më 24 mars 1999, lufta e UÇK-së e rezistenca e të gjithë shqiptarëve deri më 9 qershor, ditën e nënshkrimit të Marrëveshjes së Kumanovës që shënoi fundin e sundimit serbo-jugosllav, i kapërceu vendimet dhe vetë Marrëveshjen e Rambujesë. Por asnjëherë nuk duhet harruar se mamia që asistoi lindjen e shtetit të lirë dhe të pavarur të Kosovës ishte Konferenca e Rambujesë, por ajo që mbolli farën ishte rezistenca mbarëshqiptare dhe kurora e saj, Ushtria Çlirimtare e Kosovës.

(Marrë nga libri “Ushtria Çlirimtare e Kosovës, vlerë kombëtare”, botuar nga Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës. Kjo kumtesë është paraqitur në sesionin shkencor mbajtur në Prishtinë më 7 mars 2022, organizuar nga: Instituti Albanologjik i Prishtinës, Drejtoria e

Përgjithshme e Arkivave e Shqipërisë dhe Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës. Kumtesat e njëzet intelektualëve shqiptarë gazeta “Epoka e re”, përpos në portal, do t'i botojë për njëzet ditë me radhë edhe në formatin pdf. Librin mund ta gjeni në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës.)

¹ Deklarata e Grupit të Kontaktit për Kosovën, Londër, 29 janar 1999. Arkivi i Ministrisë për Evropën e Punët e Jashtme (AMEPJ), 1999.

² Koha ditore, 3 shkurt 1999.

³ Draft Kosovo Interim Agreement (January 27, 1999), AMEPI, 1999.

⁴ Po aty.

⁵ Po aty.

⁶ Wolfgang Petritsch, Robert Pichler, *Rruga e gjatë në luftë, Kosova dhe Bashkësia Ndërkombëtare: 1989-1999*, Koha, Prishtinë, 2002, f. 180.

⁷ Paskal Milo, *Ditari i një ministri të Jashtëm, konflikti i Kosovës: 1997-2001*, Toena, Tiranë, 2009, f. 146.

⁸ Bill Clinton, *Ne luftën, ju paqen: mesazhe, artikuj, konferencë shtypi, intervista dhe fjalime për Kosovën*, gazeta Albania, 2000. Përgatiti për botim Lutfi Dervishi, f. 13.

⁹ Wolfgang Petritsch, Robert Pichler, *Rruga e gjatë në luftë, Kosova dhe Bashkësia Ndërkombëtare: 1989-1999...*, f. 185.

¹⁰ Blerim Shala, *Vitet e Kosovës 1998-1999*, botimi i dytë, Gama, Prishtinë, 2001, f. 257.

¹¹ Rexhep Qosja, *Paqja e përgjakshme, Konferenca Ndërkombëtare për Kosovën*, Rambuje, 6-23.2.1999; Paris 14-19.3.1999; New York, 1999, f. 202.

¹² Tim Judah, *Kosova, luftë dhe hakmarrje*, Koha, Prishtinë, ShLK, Tiranë, 2000, f. 261.

¹³ Paskal Milo, *Ditari i një ministri të Jashtëm, konflikti i Kosovës...*, f. 157.

¹⁴ Wolfgang Petritsch, Robert Pihler, *Rruga e gjatë në luftë: Kosova dhe Bashkësia Ndërkombëtare...*, f. 203.

¹⁵ Joshka Fischer, *Vitet kuq-gjellbër, politika e jashtme gjermane - nga Kosova deri në 11 shtator*, Koha, Prishtinë, 2008, f. 140-141.

¹⁶ Paskal Milo, *Ditari i një ministri të Jashtëm, konflikti në Kosovë*, 1997-2001..., f. 13.

¹⁷ Tony Blair, *Për shqiptarët: fjalime, artikuj, intervista, mesazhe, komente, deklarata...* Përgatiti Ramiz Lushaj, Qendra Shqiptare e Studimeve Amerikane dhe Britanike, Albania, Tiranë, 2005, f. 37.



Shoqata e Prokurorëve e Kosovës kërkon anulimin e vendimit të qeverisë

PRISHTINË, 24 NËNTOR - Shoqata e Prokurorëve e Kosovës ka kërkuar anulimin e vendimit të Qeverisë së Kosovës për përgjysmimin e pagave të prokurorëve. Po ashtu, kjo shoqatë përkrah vendimin e Këshillit Prokurorial të Kosovës të marrë dje në takimin e vet të jashtëzakonshëm për reduktimin e punëve të prokurorive vetëm me

shërbime esenciale për pezullimin e të gjitha formave të bashkëpunimit me përfaqësuesit e Qeverisë së Republikës së Kosovës si dhe për veprimet e tjera që parasheh vendimi i KPK-së. Shoqata e Prokurorëve e Kosovës ka njoftuar se në bashkëpunim me Këshillin Prokurorial të Kosovës do të ndërmarë veprime konkrete për kontestimin e vendimit të Qeverisë së

Republikës së Kosovës për uljen e pagave të prokurorëve përmes rrugëve ligjore dhe organeve gjyqësore vendimmarrëse. “Gjithashtu, do të shqyrtohen edhe shkeljet e mundshme të dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe për hapat lidhur me këtë çështje opinioni do të njoftohet me kohë”, ka njoftuar Shoqata e Prokurorëve e Kosovës.



Vullnetarët e rinj të Korpusit të Paqes fillojnë shërbimin dyvjeçar në Kosovë



Prishtinë, 24 nëntor - Shtatëmbëdhjetë vullnetarë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës u betuan në Prishtinë për të shërbyer në Korpusin e Paqes. Ceremonia e betimit të tyre pasoi pas përgatitjeve 11-javëshe në disa zona të Kosovës, para se të nisnin punën, disa prej tyre në shkollë për t'i ndihmuar nxënësit që ta mësojnë gjuhën angleze dhe disa të tjerë në organizata joqeveritare në vend për dy vjetet

e ardhshëm. Drejtoresha e Korpusit të Paqes për Kosovën, Carolyne Siganda, tha se vullnetarët vijnë nga 15 zona të ndryshme të Shteteve të Bashkuara nga më shumë se 40 institucione të arsimit të lartë. “Ju sillni një sfond të pasur e të shumëllojshëm të prejardhjes dhe kulturës që jam e sigurt se do ta ndani me njerëzit në Kosovë. Jam e bindur se çdonjëri nga ju do të japë kontribut të

rëndësishëm në shkollë dhe organizata ku do të punoni”, u tha ajo vullnetarëve. Zëvendësambasadorja e Shteteve të Bashkuara në Prishtinë, Alyson Grunder, tha se betimi i vullnetarëve ka një rëndësi të posaçme këtë vit pas dy vjetëve të ndërprerjes së këtij programi për shkak të pandemisë Covid-19. Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, tha se puna e

vullnetarëve të Korpusit të Paqes forcon miqësinë e thellë ndërmjet Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Vullnetarët thanë se janë mirënjohës për pritjen që u është bërë nga qytetarët e Kosovës. Ky është grupi i shtatë i vullnetarëve të Korpusit të Paqes në Kosovë. Grupi i parë qëndroi në Kosovë në vitin 2014, një vit pasi që Kosova dhe Shtetet e Bashkuara nënshkruan marrëveshje

ndërshtetërore për hapjen e programit të parë të Korpusit të Paqes. Korpusi i paqes është themeluar nga presidenti John Kennedy në mars të vitit 1961. Që atëherë më se 200 mijë amerikanë kanë shërbyer në 140 vende të ndryshme të botës në çështje që nga lufta kundër sëmundjeve, në fushën e arsimit, teknologjisë informative e deri te mbrojtja e mjedisit.

Katër autoambulanca të reja i shtohen QKMF-së në Prishtinë

PRISHTINË, 24 NËNTOR - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama,

ka bërë me dije se katër autoambulanca të reja i shtohen QKMF-së në

Prishtinë. “Prioritet kemi rritjen e numrit dhe cilësinë e shërbimeve shëndetësore

për qytetarët e kryeqytetit”, ka shkruar Rama në “Facebook”.



Komuna e Mitrovicës shpërndan fidane të arrës, lajthisë dhe sistem të ujitjes për 12 fermerë

MITROVICË, 24 NËNTOR - Në kuadër të mbështetjes së fermerëve me subvencione nga komuna e Mitrovicës, të enjten është bërë shpërndarja e fidaneve të arrës për 11 fermerët përfitues dhe një fermeru me fidane të lajthisë si dhe sistem të ujitjes.

Me rastin e ndarjes së këtyre fidaneve morën pjesë kryetari i komunës, Bedri Hamza, nënkryetari i komunës, Arian

Tahiri, si dhe drejtori i Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Ferdi Kadriu.

Në fjalën e tij, kryetari Hamza, pasi i ka përgëzuar fermerët përfitues të këtyre fidaneve, ka theksuar se përkrahja e komunës për fermerët do të jetë e vazhdueshme, sepse mbështetja ndaj tyre nënkupton mirëqenie të qytetarëve dhe motivim për t'u marrë me bujqësi.

Kurse drejtori i Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Ferdi Kadriu, ka bërë me dije se janë ndarë gjithsej 1045 fidane të arrës dhe 95 fidane të lajthisë.

“Secili fermer ka përfituar nga 95 fidane dhe sistemin e ujitjes, ndërsa totali është 5 hektarë pemishte. Vlera e këtij projekti arrin shifrën mbi 9 500 euro”, ka thënë drejtori Kadriu.



BE-ja anulon grantin 28 milionë euro të Fondit të Investimeve për portin e Durrësit



TIRANË, 24 NËNTOR - Është anuluar granti i Fondit të Investimeve për Ballkanin Perëndimor për portin e Durrësit, ka bërë me dije për “Radion Evropa e Lirë”, zyra e Bashkimit Evropian në Tiranë. Shkak për këtë vendim është bërë edhe modifikimi i projektit. “Si rezultat i modifikimit të projektit dhe ndryshimit të përdorimit të portit aktual, BE-ja ka anuluar grantin e mbetur të WBIF (Fondi i Investimeve për Ballkanin Perëndimor) për investimin për projektin e mëparshëm të portit. Ne jemi duke u konsultuar me përfaqësuesit e qeverisë edhe

për prioritetet e investimeve”, thuhet në përgjigjen e tyre.

Vlera e këtij granti ishte 28 milionë euro.

Projekti parashikonte rehabilitimin e kalatave 1 dhe 2 në Terminalin Perëndimor të Portit të Durrësit, ku përpunohen thujtë të gjitha mallrat që vijnë nga jashtë. Ndërhyrja ishte e domosdoshme pasi njëra prej tyre është ndërtuar në vitet 1945-1951, tjetra më 1972. Ndërhyrjet e vetme janë bërë më 1994. Projekti i financuar edhe nga BE-ja parashikonte zgjerimin e sipërfaqes së kalatave si dhe rritjen e thellësisë së projektuar në

mënyrë që të ankorohen edhe anije më të mëdha.

Ndërkohë, marrëveshja e nënshkruar ndërmjet qeverisë shqiptare dhe investitorit nga Dubai, Mohamed Alaabar, e shndërron portin aktual në port jahtesh dhe e kthen Durrësin, siç është shprehur kryeministri Rama, në “Dubain e Mesdheut”, ndërsa aktiviteti tregtar do të zhvendoset në Porto Romano. Aktualisht në këtë zonë operon një kompani private dhe aty përpunohen ngarkesa me naftë.

Me një vendim të këshillit të ministrave në qershor të 2021-s u vendos të zgjerohet porti ekzistues në Porto Romano,

duke i hapur rrugë kështu transferimit të portit tregtar atje dhe ndërtimit të portit turistik nga kompania arabe.

Në përgjigjen e zyrës së BE-së në Tiranë thuhet se “sa i përket marrëveshjes tregtare ndërmjet Shqipërisë dhe Emirateve të Bashkuara Arabe, BE-ja do të vazhdojë ta monitorojë rëndësinë për MSA-në dhe pajtueshmërinë me të në dialog me institucionet shqiptare”.

Edhe në gusht të këtij viti delegacioni i BE-së në Shqipëri i kërkoi qeverisë më shumë qartësi dhe transparencë në lidhje me marrëveshjen me kompaninë arabe sa i përket projektit të marinës në Portin e

Durrësit.

Projekti i investitorit nga Dubai, Mohamed Alaabar, për Marinën e Jahteve në Portin e Durrësit, ka sjellë përplasje në politikën shqiptare. Sipas opozitës, shkelet marrëveshja e MSA-së si dhe pas projektit fshihen interesat personale të kryeministrit shqiptar Edi Rama.

Pak ditë më parë kreu i grupit të PD-së, Enkelejd Alibej, bëri me dije se për këtë çështje i është drejtuar me një letër ambasadës së BE-së në Tiranë dhe komisionarit Oliver Varheyli. Marrëveshja për portin e Durrësit kalon të enjten për votim në Kuvend.

Oda Ekonomike e Kosovës dhe ajo e Kroacisë diskutojnë për bashkëpunim

PRISHTINË, 24 NËNTOR - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Lulzim Rafuna, gjatë vizitës në Zagreb është takuar me

kryetarin e Odës Ekonomike të Kroacisë, Luka Burilovic. Në takim palët kanë diskutuar për zhvillimet e deritanishme

dhe për bashkëpunimin ndërmjet OEK-ut dhe HGK-së si dhe për mundësitë e bashkëpunimit në të

ardhmen. Pikë kryesore e diskutimit ishte procesi i digjitalizimit të OEK-ut dhe mundësitë e përkrahjes nga HGK-ja në këtë drejtim.



EURO GLASS
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
 Enverti
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
 TEL: 045/82 82 82

Drita ndan rrugët me trajnerin Ardian Nuhiu

Skuadra e Dritës dhe Ardian Nuhiu kanë ndarë rrugët pas plotë katër vjetësh. Eliminimi nga Kupa ka qenë vendimtar në "divorcin" me klubin gjilanas dhe trajnerit nga Maqedonia e Veriut

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 24 NËNTOR - Ardian Nuhiu nuk do të jetë më trajner i Dritës, pasi klubi me vendim të dyanshëm ka vendosur t'i japë fund bashkëpunimit me trajnerin nga Shkupi.

Drejtori gjeneral Feti Murseli në konferencën e jashtëzakonshme ka thënë se deri te vendimi për

ndarjen me Nuhiun ka qenë eliminimi i hershëm nga gara e Kupës. Siç dihet, të mërkurën Drita pësoi humbje nga Liria me rezultat 1-2. "Kemi marrë vendimin e ndërprerjes së bashkëpunimit me trajnerin Nuhiu. Arsyeja mund të lidhet me eliminimin e hershëm nga Kupa e Kosovës. Menjëherë pas ndeshjes jemi takuar me presidentin, kemi biseduar edhe me trajnerin dhe vendosëm ta



ndërpresim bashkëpunimin katërvjeçar. E falënderojmë për kontributin dhe suksesin në futbollin vendor dhe atë ndërkombëtar. I dëshirojmë suksese në karrierën dhe e

falënderojmë për përzemërsisht për të mirat që i dha klubit tonë. Me plot bindje them se nuk është lamtumirë, por vetëm një mirupafshim", ka thënë Murseli. Në konferencë i pranishëm ishte edhe Nuhiu, i cili ka lënë të nënkuptohet se ndarja ka qenë miqësore. Ai ka thënë se edhe përkundër asaj se më nuk do të jetë në krye të shtabit teknik, Drita do të ketë një vend të veçantë në zemrën e tij. "Dua ta falënderoj këtë familje të madhe të klubit - Dritën. Katër vjet të jashtëzakonshëm. Emocione, histori, fitore, humbje, dhimbje, më tepër gëzime. Falënderoj dy

presidentët dhe drejtuesit që gjithmonë, 24 orë, kemi qenë bashkë për të mirën e kësaj skuadre. Falënderoj edhe tifozët. Mbështetja ka qenë e jashtëzakonshme nëpër stadione. Stafit tim, stafit mjekësor dhe, më të rëndësishmëve, secilit futbollist që kaloi këtë derë gjatë këtij rrugëtimit i jam falënderues, sepse pa ta s'do t'i kishim sukseset. Ky klub do të ketë vend të veçantë në zemrën time, sepse vërtet kemi kaluar jashtëzakonisht mirë", ka deklaruar Nuhiu, i cili ishte shpallur një herë kampion i Kosovës me Dritën në edicionin 2019/2020.

Brazili tregon forcën ndaj Serbisë, Portugalia mposhti Ganën

LUSAIL, 24 NËNTOR - Brazili tregon menjëherë forcën në Katar 2022, duke marrë një fitore spektakolare 2-0 ndaj Serbisë. 3 pikë të merituar për ekipin e Tite-s që zhvillon një duel mjaft të mirë. "Selecao" nuk shkoi më shumë se një barazim pa gola në 45 minutat e para kundër Serbisë. Në minutën e 13-të, Neymar tentoi të shënonte nga goditja e këndit, por Milinković-Saviq e kuptoi mjaft mirë idenë e tij. Casemiro pak minuta më pas provoi me një goditje të fortë nga distanca, ndërkohë që Vinicius Junior nuk shfrytëzoi si duhet një asistim nga Thiago Silva që e nxori përballë. Pjesa e dytën ndërkohë u dominua totalisht nga Brazili, që do të



zhbllokonte më në fund sfidën. Në minutën e 63-të, Vinicius godet dhe ndalet nga portierit Milinković-Saviq, por më pas shkon te Richarlison, i cili e ka të

thjeshtë për ta shtyrë topin në rrjetë. Dhjetë minuta më pas është sërish Richarlison që shënon një super gol me një goditje spektakolare me roveshatë pasi

mori një top nga Vinicius Junior. Asnjë shans reagimi për portierin serb, i cili nuk mundi ta evitonte këtë perlë. Brazili me këtë fitore udhëheq grupin me 3 pikë, po aq sa Zvicra. Ka përfunduar me rezultatin 3 me 2 në favor të Portugalisë ndeshja e luajtur, në "Stadiumun 974" të Dohas, përballë Ganës. Pjesa e parë e parë ishte e vakët me të dyja ekipet të cilat nuk patën rast të shumta shënimi. Me startin e pjesës së dytë situata ndryshoi me të dyja ekipet të cilat u hodhën furishëm në sulm, për të gjetur golin e avantazhit. Fillimisht do të ishte kapiteni i "luzitanëve", Cristiano Ronaldo, që do të gjente rrugën e rrjetës falë një penalltie të akorduar

në minutën e 65'. Kundërpërgjigja afrikane do të ishte e shpejtë ku pas vetëm 7' minuta, ku në 73'-ën, Jordan Ayew do të vendoste baraspeshën, por nuk do të mbaronte me kaq, pasi në minutat 79' dhe 80' falë 2 aksioneve të shpejta ekipore, Felix dhe Leao rikthyen portugezët në avantazh. Gana arriti të shënonte sërish në minutën e 89', këtë herë me Osman Bukari, por goli do të shërbente vetëm për statistikë, pasi ndeshja mbeti e pandryshuar deri në fund. Me këtë fitore Portugalia vendoset në vendin e parë në grupin H, duke lënë kështu pas tyre Uruguain dhe Korenë e Jugut, të cilat ndanë nga një pikë në ndeshjen e luajtur në orën 14:00.

Zvicra e nis me fitore Botërorin, Uruguai dhe Koreja e Jugut ndahen baras

Al-Wakrah, 24 nëntor - Zvicra e ka nisur në mënyrën më të mirë të mundshme kampanjën në Kampionatin Botëror, duke triumfuar ndaj Kamerunit me rezultat 1-0. Golin e vetëm dhe të fitores për helvetikët e shënoi Breel Embolo në minutën e 51', pas një asistimi nga Xherdan Shaqiri. Kameruni ishte skuadra që rrezikoi më shumë gjatë gjithë ndeshjes, por nuk arriti t'i konkretizojë rastet. Zvicra në ndeshjen e ardhshme do të përballet me Brazilin, ndërsa

Kameruni me Serbinë. Në ndeshjen tjetër, Uruguai dhe Koreja e Jugut nuk shkuan më shumë se një barazim 0-0. Koreja ka qenë shumë e rrezikshme në fazën sulmuese. Në minutën e 34-t U-i-Jo Hwang iu afrua shumë golit të avantazhit, por për fatin e tij të keq goditja do të përfundonte jashtë kuadrantit. Shansi më i artë ishte për Uruguain. Në minutën e 43-të, pas një kërcimi të bukur, Diego Godin godet mjaft mirë me kokë, por tentativa e tij stampohet në shtyllën e djathtë të portierit.

Në pjesën e dytë Koreja luan më mirë, duke pretenduar një penallti pasi Bentancur tërhoqi një nga kundërshtarët në zonë, por arbitri francez Turpin vijoi lojën. Nunez në krahun tjetër iu afrua golit me një goditje në hyrje të zonës që shkoi ngjitur me kuadratin. Në minutat e fundit, goditja spektakolare e Valveredes do të ndalej vetëm nga shtylla, njësoj si në pjesën e parë. Koreja u kundërpërgjigj sërish në të njëjtën mënyrë me një goditje të Son që shkoi ngjitur me portën.



Ballkani kualifikohet më tutje në Kupë

PEJË, 24 NËNTOR - Kampioni në fuqi i Kosovës në futboll, Ballkani i Suharekës, është kualifikuar në garën e Kupës.

Ballkani e ka mposhtur me rezultat 3-1 në udhëtim Phoenixin në rrethin e 1/16-tës së finale. Golat për Ballkanin i

shënuan Zarubica (23'), Kuç (64') dhe Gripshi (87'), kurse për skuadrën e Ligës së Parë golin e vetëm e shënoi Ediae Precious.

Të mërkurën kualifikimin tutje e siguroi edhe skuadra e Lirisë së Prizrenit që e mposhti Dritën e Gjilanit me rezultat 1-2.



Kosova me pesë përfaqësuese të reja në arenën ndërkombëtare

PRISHTINË, 24 NËNTOR - Përfaqësueset e reja të Kosovës do të marrin pjesë si zakonisht në garat ndërkombëtare. Gjatë verës së ardhshme të meshkujt do të garojnë Kosova U20 në Divizionin B, Kosova U18 në

Divizionin B dhe Kosova U16 në Divizion C, që do të organizohet në Prishtinë. Ndërkohë te femrat, Kosova do të paraqitet me U20 në Divizionin B dhe me U18 në Divizionin C. Divizioni B i meshkujve për U20 do të

organizohet në Shkup të Maqedonisë Veriore nga 7 deri më 16 korrik 2023. U18 i meshkujve mbahet në Matosinhos të Portugalisë nga 21 deri më 30 korrik 2023. U16 i Divizioni C do të organizohet në Prishtinë nga 15 deri më 23

korrik 2023. Ndërkohë, te femrat U20 i Divizioni B do të zhvillohet në Craiova të Rumanisë nga 28 korriku deri më 6 gusht 2023. Divizioni C i femrave U18 do të mbahet në Durrës të Shqipërisë nga 1 deri më 6 gusht 2023.



Beckhami synon ta blejë Unitedin

MANCHESTER, 24 NËNTOR - Ta shohësh David Beckhamin si një nga pronarët e rinj të Manchester Unitedit nuk është aq larg sa duket. "Glazers" ka nxjerrë në shitje klubin e "Old Trafford"-it dhe ish-futbollisti është i hapur për negociatën për ta marrë atë. Sipas informacioneve në shtypin anglez, Beckham do të kishte thënë se është i hapur për bisedime me çdo blerës të mundshëm të Manchester Unitedit. Ish-futbollisti nuk kishte mundësi të merrte vetë një nga lojtarët e mëdhenj të Premierligës, por mund të bëhej pjesë e një kompanie investimi për ta blerë klubin. Informacioni i publikuar nga "The Times" zbulon se Beckhami është i hapur për të zhvilluar bisedime me ofertuesit e mundshëm për Unitedin. Ai që ishte lojtar i "Djajve të Kuq" do të dëshironte të rikthehej në atë që ishte klubi i tij dhe ku ishte stërvitur si lojtar që nga radhët e të rinjve. Marrëdhënia sentimentale e



Beckhamit me Manchester Unitedin dhe dashuria e tifozëve mund t'i bëjë "Glazers", kur bëhet fjalë për shitjen, të zgjedhin kompaninë e investimeve në të cilën ish-futbollisti është aktiv. "The Times" tregon se investitorë të ndryshëm iu afruan Beckhamit në të kaluarën, por bisedimet nuk u realizuan kurrë. Sipas këtyre informacioneve, ish-kapiteni i Anglisë do të ishte më i hapur se kurrë për të negociuar një marrëveshje, pasi Unitedi konfirmoi të martën se pronarët e

tyre amerikanë ishin të gatshëm ta shesin klubin. Familja "Glazer", e cila është përballur me kundërshtime të konsiderueshme gjatë mandatit të saj, njoftoi të martën se do të ishte e gatshme ta shesë klubin pas 17 vjetësh si pronare e Unitedit. Në deklaratën e tyre pronarët aktualë të klubit nga "Old Trafford" thanë se do t'i shqyrtonin të gjitha opsionet, duke përfshirë "një investim të ri në klub, një shitje ose transaksione të tjera".

Boston bën ligjin në NBA

BOSTON, 24 NËNTOR - Bostoni mbetet skuadra më e mirë këtë sezon në NBA, duke korrur fitoren e 14-t. Celticsi mposhti Dallasin (125-112), sfidë ku gjashtë lojtarë realizuan mbi 10 pikë. Më të mirët ishin Tatum me 37 pikë e 13 rebounde si dhe Browni me 31 pikë, duke i bërë të pavlefshme 42 pikët e Luka Donçiqit për miqtë. Ekipi kampion i Golden States



fitoi me rezultat 124-107 ndaj Clippersave në një përballje të dominuar nga vendasit. Wiggins me 31 pikë e Curry me 22, bënë diferencën në parket. Skuadra e Milwaukeees zhgënjën sërish, duke u mundur me shifrat 118-113 në fushën e saj nga Chicagos. Giannis realizoi 36 pikë e 11 rebounde, por që mbetën për statistikë, ndërsa për Bulls-in u dallua DeRozan po me 36 pikë.

Jashtë fushës fiton Brooklyn, që mundi me rezultat 112-98 Toronton, sfidë ku u dallua Irvingu me 29 pikë. Detroiti, falë 23 pikëve të Bogdanoviqit, mposhti 125-116 Uah Jazzin, ndërsa Charlotte triumfoi 107-101 ndaj Philadelphias (Rozier 22 pikë). Pas kohës shtesë fitoi Denveri, që mundi 131-126 Oklahoman (Jokiq 39 pikë e 10 rebounde).

REZULTATET

Charlotte - Philadelphia	107-101
Cleveland - Portland	114-96
Indiana - Minnesota	101-115
Atlanta - Sacramento	115-106
Boston - Dallas	125-112
Miami - Washington	113-105
Toronto - Brooklyn	98-112
Milwaukee - Chicago	113-118
Oklahoma - Denver	126-131
San Antonio - New Orleans	110-129
Utah Jazz - Detroit	116-125
Golden State - Clippers	124-107

Daniel Ricciardo rikthehet te Red Bull, Mick Schumacher drejt Mercedesit

Piloti australian Daniel Ricciardo, një nga veteranët e Formulës 1, rikthehet te skuadra Red Bull. Ai do të jetë piloti i tretë i makinës kampione të botës për vitin 2023. Lajmi është zyrtarizuar nga Red Bull, që

rikthen në radhët e saj pas katër vjetësh Ricciardo. "Është një kënaqësi të rikthesh Ricciardon në ekipin tonë. Ka mjaft talent dhe përvoja e tij është e rëndësishme për ne", ka thënë Christian Horner, shefi i Red

Bullit. Ndërsa vetë piloti shtoi: "Buzëqeshja ime tregon se sa i lumtur jam për këtë rikthim në familjen time". Ndërsa piloti i ri gjerman Mick Schumacher pritet të jetë piloti i tretë i Mercedesit. Lajmin e

konfirmoi Toto Wolff, shefi i makinës gjermane, që ka thënë se djali i shtatë herë kampionit të botës është personi i përshtatshëm për këtë detyrë. "Ne e kemi për zemër Mick, pasi edhe babai i tij ka qenë pjesë e

familjes sonë. Është i ri, inteligjent dhe dy sezonet me Haasin e kanë pjekur. Do të jetë e rëndësishme për të ardhmen e tij dhe tonën të punojmë së bashku nëse arrijmë marrëveshjen", ka thënë Toto Wolff.

SHKURT

Ylli mposhtet nga Niners Chemnitz

Kampioni i Kosovës, Golden Eagle Ylli, ka pësuar humbje nga Niners Chemnitz me rezultat 72:101 (24:24, 13:34, 13:20, 22:23), në ndeshjen e pestë të grupeve në FIBA Europe Cup. Te Golden Eagle Ylli u dalluan Malcolm Armstead me 18 pikë dhe Henrik Sirko me 12, kurse te mysafirët më i miri ishte Arnas Velicka me 13 pikë e dhjetë kërcime. Ylli ka një fitore e katër humbje në grupe, kurse Niners tri fitore e dy humbje. Ndeshjen e ardhshme dhe të fundit në grupe, therandasit e zhvillojnë ndaj Bambergut më 30 nëntor në Prizren.

Aston Villa e dëshiron Muriqin

Aston Villa është gati të bëjë një ofertë për sulmuesin e Mallorcas, Vedat Muriqi, raporton "Futbol Total". Klubi anglez është gati të bëjë një ofertë prej 20 milionë eurove për sulmuesin e Kosovës edhe pse Mallorca po reziston për klauzolën e lirim të prej 40 milionë eurosh. Ish-sulmuesi i Kosovës ka shënuar 119 gola gjatë karrierës së tij për klubin dhe kombëtaren, tetë prej të cilëve në 12 paraqitje në La Liga këtë sezon.

Chelsea nuk do ta transferojë Ronaldon

Cristiano Ronaldo është aktualisht lojtar i lirë, pasi shkëputi marrëveshjen me skuadrën e Manchester Unitedit. Emri i portugezit lidhet me një kalim të mundshëm te Chelsea por, sipas "The Sun - Sky", londinezët nuk janë të interesuar për nënshkrimin me portugezin. Ronaldo lidhet me një kalim të mundshëm në "Stamford Bridge" edhe gjatë verës, por Thomas Tuchel bllokoi transferimin e tij. Todd Boehly, pronar i Chelseat, është, megjithatë, i interesuar për transferimin e Ronaldos, por kundër këtij transferimi duket të jetë trajneri Graham Potter.

Neuer: Tash jemi nën presion

Gjermania pësoi humbje në ndeshjen e parë të Kupës së Botës nga Japonia (1-2). Kapiteni Manuel Neuer e ka pranuar se tash gjermanët janë nën presion, pasi ndeshjen e radhës e kanë kundër Spanjës. "Duhet të përmirësojmë shumë gjëra, por tani jemi nën presion. Kundër Japonisë ishte ndeshja më e rëndësishme dhe ne e humbëm, ndaj Spanjës duhet një tjetër paraqitje, duhet të japim gjithçka kundër një kundërshtari shumë të vështirë", ka thënë Neuer.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "AARE HOLZBAU AG" SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811923235 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "AARE HOLZBAU AG" D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811923235 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability "AARE HOLZBAU AG" L.L.C. has come to the decision to quit its business: 811923235 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage - mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- "Daimo Mobilie" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 33012394.

- "Moda Center" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 33012401.

- Sadete Mani shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Azem Bejta".

- Sead Ismaili shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Meto Bajraktari".

- Valbone Sylejmani shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Shemsi Ahmeti".

- Afrim Elshani shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Andon Zako ÇAJUPI".

- Zyrafete Kurhaski shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të SH.F. "Ali M. Hasi", Cërmjan, komuna e Gjakovës.

- Infermierja e përgjithshme, Rabe Nikçi nga komuna Pejës me numër personal 1003700182, shpalli të humbur Licencën e Punës me numër: KO-3462-05-20, me afat prej 03.01.2018 deri 03.01.2023.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

Lume's Details

Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



Ndërmarrja Publike Lokale
"Prishtina Parking" Sh. A. Prishtinë



Në bazë të nenit 164 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare 06/L-016, nenit 16.2 dhe 17 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr. 03/L-087 (GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI III/Nr. 31/15 QERSHOR 2008), dhe plotësim ndryshimeve përkatëse me Ligjin nr. 04/L-111 dhe nr. 05/L-009, dhe në pajtim me normat tjera pozitive relevante, Komisioni Komunal i Aksionarëve të NP "Prishtina Parking" Sh.a, Prishtinë, me datën **25.11.2022**, shpall këtë:

KONKURS

Pozitat: Katër (4) anëtarë të Bordit të Drejtorëve të NP "Prishtina Parking" Sh.a, Prishtinë

I përgjigjen: Komisionit Komunal të Aksionarëve të NP "Prishtina Parking" Sh.a, Prishtinë

Mandati: Tri (3) vite.

Kompensimi: Konform nenit 20 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr. 03/L-087, dhe plotësim ndryshimeve përkatëse.

1. Të përgjithshme

Kandidati/ja për këtë vend pune duhet të jetë person me integritet, i cili/e cila i plotëson kushtet e kualifikimit dhe kriteret e pavarësisë, posedon përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar, si dhe i plotëson kushtet tjera të kërkuara me dispozitat e Ligjit për Ndërmarrjet Publike dhe aktet tjera pozitive relevante.

2. Kushtet e kualifikimit profesional dhe përshtatshmërisë

Çdo kandidatë për t'u konsideruar në pozitën e Drejtorit të Bordit, duhet të ketë së paku pesë (5) vite përvojë – së paku në një nivel të lartë të menaxhmentit në fushat si vijon:

- në administrim të biznesit;
- financa të korporatave;
- financa;
- menaxhim thesari;
- banka;
- konsulencë në biznes ose industri; ose
- nga një fushë tjetër e shkencës ose njohurisë e cila ka të bëjë me veprimtarinë afariste të ndërmarrjes; ose
- për së paku pesë (5) vite, të ketë qënë kontabilist publik, jurist i kualifikuar, ose anëtar i kualifikuar i një profesioni tjetër i cili ndërlidhet ngushtë me veprimtarinë afariste të NP-së.

3. Papajtueshmëria

Konform ligjit në fuqi, një person nuk ka të drejtë të shërbejë si drejtor në Bordin e ndërmarrjeve publike, nëse:

- a) Ka qenë i/e dënuar nga një gjykatë kompetente, përveç nëse ky dënim ose vendim më pas është ndryshuar nga një gjykatë tjetër në bazë të ankesës; ka kryer vepër penale ose civile, vepër që përfshinë përgënjeshtrimin, prezantimin e rrejshëm, korrupsionin, vjedhje, pastrimin e parave, përvetësimin, keqpërdorimin apo ndarjen e rrejshme të fondeve; ka qenë i/e përfshirë në mitosje apo ryshfet sipas ligjeve apo rregulloreve në fuqi në Kosovë apo ndonjë vend tjetër, apo sipas traktateve ose konventave ndërkombëtare;
- b) është vendosur nga një gjykatë ose organ apo organizatë përgjegjëse për zbatimin e kodit etik apo standardeve të sjelljes profesionale, përveç nëse ky dënim ose vendim më pas është ndryshuar nga një gjykatë ose organ tjetër në bazë të ankesës (i) se është angazhuar në sjellje jo-profesionale, (ii) se ka shkelur kodin etik apo standardet e sjelljes profesionale, (iii) se ka keqpërvetësuar apo ka keqpërdorur paratë apo burimet publike, (iv) se ka keqpërdorur apo keqpërvetësuar informatat (të dhënat) e fituara gjatë shërbimit si zyrtar publik apo shërbyes civil, ose (v) se ka keqpërdorur postin publik ose postin në shërbimin civil për përfitime personale ose për përfitime apo përparësi të një të afërmi ose të njohuri; apo;
- c) ka bërë përgënjeshtrime materiale nën çfarëdo dëshmie nën betim apo betimi tjetër, ose dokumenti të vulosur apo noterizuar; dhe
- d) është shpallur i falimentuar gjatë dhjetë (10) viteve të kaluara;
- e) punon në ndonjë institucion ku bëhen politikat zhvillimore për Ndërmarrje Publike përkatëse ku kandidati punon.

Të gjithë drejtorët duhet të jenë të pavarur. Një person nuk konsiderohet i pavarur dhe nuk kualifikohet për zgjedhje si drejtor në një NP nëse:

- a) aktualisht është zyrtar ose menaxher i NP-së përkatëse ose cilëso nga filialet e saj, ose ka shërbyer si zyrtar ose menaxher i NP-së përkatëse ose cilëso nga filialet e saj brenda pesë (5) viteve të kaluara;
- b) aktualisht është punonjës i nivelit të lartë i NP-së përkatëse, ose ka shërbyer si punonjës i nivelit të lartë në NP-në përkatëse brenda tri (3) viteve të kaluara;
- c) aktualisht ka, ose gjatë tri viteve të kaluara ka pasur, çfarëdo marrëdhënie materiale afariste (përveç si konsumator individual i shërbimeve të NP-së) me NP-në përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë;
- d) është aksionar, drejtor, zyrtar ose punonjës i lartë në një shoqëri tregtare ose person tjetër juridik i cili ka marrëdhënie materiale afariste me NP-në përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj;

- e) pranon, ose ka pranuar brenda tri (3) viteve të kaluara, kompensim shtesë nga NP përkatëse ose cilëdo nga filialet e saj (përveç honorarit të Drejtorit ose kompensimit stimulues të përcaktuar në nenin 20.1 të ligjit primar, ose është anëtar në skemën pensionale të NP-së përkatëse ose cilëso nga filialet e saj;
- f) mban drejtorësi të ndërsjellë ose ka lidhje të konsiderueshme me drejtorët e tjerë të NP-së përkatëse përmes përfshirjes në shoqëri tjera tregtare ose organe;
- g) përfaqëson në aksionar i cili posedon dhjetë përqind (10%) të aksioneve votuese në NP-në përkatëse;
- h) ka shërbyes në Bordin e Drejtorëve të NP-së përkatëse më shumë se nëntë (9) vite nga data e zgjedhjes së parë të tij/saj; është i afërm i shkallës së tretë (siç është konstatuar në përputhje me përkufizimin e "Interesit Financiar" në nenin 2 të ligjit primar i cilitdo person që i takon cilëso nga kategoritë më sipër përveç personit të përcaktuar në pikën (b); ose
- i) është ose (i) punonjës, zyrtar, drejtor ose aksionari, ose ka një Interes Financiar në, një shoqëri tregtare të pa-listuar dhe që konkurren me Ndërmarrjen, ose (ii) menaxher i lartë, zyrtar, drejtor ose aksionar (i cili posedon më shumë se dy përqind (2%) të të drejtave të votimit) i, ose ka një Interes të konsiderueshëm Financiar në, cilëndo nga shoqëritë tregtare të listuara që konkurojnë me Ndërmarrjen; dhe
- j) është ose në çfarëdo kohe gjatë periudhës 36 muajsh para datës së aplikimit ka qenë (i) zyrtar i zgjedhur publik, (ii) i emëruar politik ose (iii) bartës i një posti udhëheqës ose vendimmarrës në një parti politike;
- l) ka çfarëdo konflikti të interesave që për nga natyra, do të shkaktonte që ky person të mos jetë në gjendje që në mënyrë rutine, me besnikëri, në mënyrë të pavarur dhe objektive t'i përmbushë detyrat etij fiduciare ndaj Aksionarëve dhe NP-së.

4. Dokumentacioni i nevojshëm

Kandidatët për drejtorë në Bordin e Drejtorëve konform këtij konkursi, duhet t'i dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- Aplikacionin (merret në zyrë e ndërmarrjes ose në web faqe të ndërmarrjes)
- CV-në
- Letër motivim
- Dëshmitë mbi kualifikimin profesional (Diplomat/Certifikatat dhe dokumente të ngjajshme të marra jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara)
- Dëshmitë mbi përvojën e punës (Aplikacioni duhet të ofroj të dhëna të sakta mbi periudhat e angazhimit dhe të korrespondojë me dokumentet vërtetuese)
- Çertifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se gjashtë muaj)
- Deklaratën nën betim (merret në zyrë e ndërmarrjes, ose në web faqe të ndërmarrjes). Me këtë dokument kandidati deklaron se ai/ajo i përmbush kushtet e kualifikimit, pavarësisë dhe ato të përshtatshmërisë profesionale sipas paragrafëve 1-3 të nenit 17 të ligjit për ndërmarrjet publike nr. 03/L-087. Çdo përgënjeshtrim material – qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca – ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në shkualifikimin e menjëhershëm dhe, nëse është e aplikueshme, largimin e personit.
- Kopjen e letërnjoftimit
- Lista kontrolluese (merret në zyrë e ndërmarrjes, ose në web faqe të ndërmarrjes).

5. Informata për procedurën e konkurrimit

Konkursi do të jetë i hapur deri me datën **27.12.2022**; Dokumentacioni i aplikantëve mund të dorëzohet në arkivin e NP "Prishtina Parking" Sh.a, Prishtinë, çdo ditë pune prej orës **8:00 – 16:00**, ose nëpërmes postës fizike; (në zarf të mbyllur) të adresuar: Për Komisionin Komunal të Aksionarëve të NP "Prishtina Parking" Sh.a, Prishtinë- "Aplikacion për Drejtor Bordin".

Të gjitha dokumentet të paraqiten në kopje, ndërsa origjinali i tyre, do të kërkohet në fazat e më vonshme të përzgjedhjes. Informatat shtesë mund të sigurohen përmes e-mail adresës: info@prishtinaparking.net, ose drejtpërdrejtë në arkivin e Ndërmarrjes. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të merren parasysh. Të gjithë formularët duhet plotësuar në tërësi, mos plotësimi i tyre dhe informatat e pasakta do të do të rezultojnë në diskualifikimin e menjëhershëm dhe, nëse është e aplikueshme, largimin e personit.

Komisioni Komunal i Aksionarëve do të zhvilloj një procedurë të hapur/transparente dhe konkurruese, ku përzgjedhja do të bëhet ekskluzivisht në bazë të meritës, konform Ligjit në fuqi dhe pa asnjëllloj diskriminimi, për çka **inkurajon** në aplikim kandidatët:

- nga gjinia femërore,
- kandidatët nga të gjitha komunitetet e Republikës së Kosovës; si dhe
- kandidatët nga të gjitha kategoritë tjera më pak të përfaqësuara në institucionet/organat/organizatat e vendit.

Vini re: Ky proces rekrutimi do të monitorohet nga përfaqësuesit e Projektit Britanik për Rekrutime në Pozita të Larta Drejtuese. Kandidatët njoftohen që emrat dhe rezultatet e kandidatëve që konsiderohen si të emërueshëm nga Partnerët Zbatues do të publikohen në uebfaqe dhe projektit. Me rastin e aplikimit për këtë pozitë, do të konsiderohet se është dhënë pëlqimi për publikimin në fjalë. Gjithashtu do të konsiderohet që pëlqimi është dhënë edhe për partnerët zbatues që të kenë qasje nga distanca dhe në mënyrë të përkohshme dhe të sigurt të ruajnë informatat rreth vlerësimit të aplikacioneve dhe performancës së tyre. Informatat e tilla do të fshihen në mënyrë permanente pasi të përfundojë vlerësimi. Në lidhje me kriterin e pavarësisë (politike) do të kontaktohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) për verifikim.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

